

LIGJI Nr. 05/L-087

PËR KUNDËRVAJTJE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR KUNDËRVAJTJE

**PJESA E PARË
DISPOZITAT MATERIALO-JURIDIKE**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE**

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë ligj rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje.

2. Ky ligj është i harmonizuar me direktivat e BE-së: Direktivën 2012/13/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 22 Maj 2012, për të drejtën në informim në procedurën penale, Direktivën 2010/64/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 20 Tetor 2010, për të drejtën për interpretim dhe përkthim në procedurën penale.

Neni 2

Nocioni i kundërvajtjes

1. Kundërvajtje është sjellja me të cilën shkelet ose rrezikohet rendi dhe qetësia publike, dhe vlerat shoqërore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mbrojtja e të cilave nuk është e mundur pa sanksionimin kundërvajtës.

2. Sanksioni për kundërvajtje mund të parashihen vetëm në pajtim me këtë ligj.

Neni 3

Parimi i ligjshmërisë

1. Askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje apo t'i shqiptohet sanksioni kundërvajtës për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës dhe për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës.

2. Në procedurën për kundërvajtje askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë, për të

njëjtën kundërvajtje.

3. Përkufizimi i një kundërvajtje duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast të paqartësisë, përkufizimi i kundërvajtjes interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura për kundërvajtje.

Neni 4

Prezumimi i pafajësisë

Askush nuk mund të dënohet dhe ndaj tij të zbatohet sanksioni kundërvajtës derisa nuk është shpall fajtor me vendim të formës së prerë.

Neni 5

Parimi i zbatimit të legjislacionit më të favorshëm

1. Ndaj kryesit zbatohet legjislacioni që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së kundërvajtjes.
2. Nëse legjislacioni në fuqi ndryshon pas kryerjes së kundërvajtjes, ndërsa para nxjerrjes së vendimit të formës së prerë për kundërvajtje, do të zbatohet legjislacioni i cili është më i favorshëm për kryesin.
3. Nëse legjislacioni i ri nuk inkriminon kundërvajtjen, po kryesi është dënuar me vendim të formës së prerë në pajtim me legjislacionin e mëparshëm, sanksioni për kundërvajtje nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.
4. Legjislacioni i cili është në fuqi për kohën më parë të caktuar, zbatohet në kundërvajtjen e kryer në atë kohë dhe pas pushimit të saj nëse me atë dispozitë nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 6

Kundërvajtjet dhe Veprat Penale

Kundër kryesit të kundërvajtjes, i cili në procedurë penale në formën e prerë është shpallë fajtorë për vepër penale e cila përfshinë edhe tipare të kundërvajtjes, nuk mund të zhvillohet procedura për kundërvajtje. Nëse procedura për kundërvajtje ka filluar apo është në rrjedhë, procedura nuk mund të vazhdohet dhe përfundohet.

Neni 7

Përcaktimi i kundërvajtjes

1. Kundërvajtjet dhe sanksionet për kundërvajtje mund të përcaktohen me ligj dhe me akte (rregullore komunale) të Kuvendit të Komunës.
2. Kuvendi i Komunës mund të përcaktoj kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje vetëm për shkeljet e akteve të organeve komunale të cilat ata i nxjerrin brenda fushës së kompetencave të tyre.
3. Organi i cili është i autorizuar të përcaktoj kundërvajtje dhe sanksione për kundërvajtje këtë autorizim nuk mund ta bartë në organe e tjera.

4. Nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, dispozitat për kundërvajtje ndaj personave fizik, zbatohen edhe ndaj personave përgjegjës në personin juridik dhe personave që ushtrojnë veprimtari të pavarur.

Neni 8

Mënyra e Kryerjes së Kundërvajtjes

1. Kundërvajtja mund të kryhet me veprim ose mosveprim.
2. Kundërvajtja kryhet me mosveprim kur kryesi ka lëshuar të kryej veprimin të cilin ka qenë i detyruar ta kryej.

Neni 9

Koha dhe vendi i kryerjes së kundërvajtjes

1. Koha e kryerjes së kundërvajtjes konsiderohet koha kur kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veproj, pavarësisht se kur është paraqitur pasoja e kundërvajtjes.
2. Kundërvajtja konsiderohet se është kryer në vendin ku kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veproj, si dhe në vendin ku në tërësi apo pjesërisht është paraqitur pasoja e kundërvajtjes.

Neni 10

Zbatimi përshtatshmërisht i legjislacionit penal të Republikës së Kosovës

Nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe, ndaj kryesit të kundërvajtjes, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodit të Drejtësisë për të Mitur si dhe Kodit të Procedurës Penale.

Neni 11

Zbatueshmëria

1. Legjislacioni për kundërvajtje zbatohet ndaj secilit person i cili kryen kundërvajtje në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Për kundërvajtjen e përcaktuar me rregulloren komunale të Kuvendit të Komunës, procedura për kundërvajtje do të zhvillohet nëse kundërvajtja është kryer në territorin e asaj njësie të vetëqeverisjes lokale.

Neni 12

Imuniteti Diplomatik

Kundër personave që gëzojnë imunitet diplomatik nuk mund të zhvillohet procedurë për kundërvajtje.

KAPITULLI II PËRGJEGJËSIA KUNDËRVAJTËSE

Neni 13

Kryesi dhe përgjegjësia

1. Kryesi i kundërvajtjes është personi i cili me veprimin ose mosveprimin e vetë ose përmes personit tjetër kryen kundërvajtje.
2. Kryesi i kundërvajtjes është përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe kundërvajtjen e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.
3. Personi është përgjegjës për kundërvajtjen e kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji.
4. Personi nuk është përgjegjës për kundërvajtje nëse në kohën e kryerjes së kundërvajtjes është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet.
5. Republika e Kosovës, institucionet dhe organet e administratës shtetërore, organet gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale nuk mund të jenë përgjegjës për kundërvajtje, ndërsa personi përgjegjës mbanë përgjegjësi për kundërvajtje.

Neni 14

Paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore

1. Çdo person i cili kryen një kundërvajtje konsiderohet i paaftë mendërisht, nëse në kohën e kryerjes së kundërvajtjes, ai lëngon nga një sëmundje e përhershme ose e përkohshme mendore, nëse ka çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që prek funksionimin e tij mendor, kështu që ai nuk është në gjendje për të kuptuar natyrën, rëndësinë apo pasojat e veprimit ose mos veprimit të tij, nuk është në gjendje të kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij, apo të kuptuarit se ai po kryen kundërvajtje.
2. Personi i cili ka kryer kundërvajtje konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së kundërvajtjes aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë, ose pasojën e veprimeve apo mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e theksuara në paragrafin 1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet përgjegjës për kundërvajtje, mirëpo rrethanat e tilla merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës tjetër.

Neni 15

Kryerja e kundërvajtjes në gjendje të dehur

Personi është përgjegjës për kundërvajtje nëse duke përdorur alkool apo me ndonjë mënyrë tjetër e sjell veten në një gjendje të tillë që nuk mund të kuptoj rëndësinë e veprimit apo të mosveprimit të vet ose të kontrollojë sjelljen e vet, nëse para se të ketë sjellë veten në gjendje të tillë, veprimet ose mosveprimet e tij kanë qenë të përfshira në dashjen e tij apo nëse është i pakujdesshëm ndaj kundërvajtjes dhe ligji parasheh përgjegjësi për kundërvajtje për kryerjen e kësaj kundërvajtje nga pakujdesia.

Neni 16

Dashja

1. Kundërvajtja mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.
2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.
3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.

Neni 17

Pakujdesia

1. Kundërvajtja mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.
2. Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj.
3. Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.

Neni 18

Lajthimi Faktik

1. Personi nuk është përgjegjës për kundërvajtjen nëse në kohën e kryerjes së kundërvajtjes nuk ka qenë i vetëdijshëm për kundërvajtjen ose ndonjë nga tiparet e saj, apo gabimisht ka menduar se ekzistojnë rrethana të cilat faktikisht po të ekzistonin kjo veprë do të ishte e lejuar.
2. Personi i cili për shkak të pakujdesisë ka qenë në lajthim për kundërvajtje, konsiderohet përgjegjës për kundërvajtjen e kryer nga pakujdesia, nëse parashihet një përgjegjësi e tillë.

Neni 19

Lajthimi Juridik

1. Nuk është përgjegjës kryesi i cili për shkaqe të arsyeshme nuk ka ditur ose nuk ka mundur të dijë se vepra e tillë e kundërvajtjes është e ndaluar.
2. Kur lajthimi ka mundur të evitohet, kryesi është përgjegjës për kundërvajtjen, por gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.
3. Lajthimi konsiderohet se është i evitueshëm, kur kryesi ka mundur lehtë të dijë se kundërvajtja është e kundërligjshme apo nëse është fjala për kryesin, i cili duke marrë parasysh funksionin, titullin, profesionin apo detyrën e tij ka qenë i obliguar të dijë për kundërligjshmërinë e veprës së tillë.

Neni 20
Bashkëkryerja

1. Nëse dy apo me tepër persona, së bashku kryejnë kundërvajtje apo nëse kontribuojnë thellësisht në kryerjen e asaj kundërvajtje, secili nga ta është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për kundërvajtje.

2. Matja e lartësisë së dënimit bëhet nga gjykata duke vlerësuar veprimin ose mosveprimin e secilit person.

Neni 21
Ndihma

Çdo person i cili ndihmon tjetrin duke e këshilluar apo duke i vënë në dispozicion mjetet për të kryer kundërvajtje i nënshtrohet një dënimi më të butë.

Neni 22
Shtytja

Kushdo që me dashje e shtytë personin tjetër të kryej kundërvajtje, dënohet sikurse ta kishte kryer vetë atë kundërvajtje, nëse ajo vepër është kryer nën ndikimin e tij.

Neni 23
Përgjegjësia e Personit Juridik

1. Personi juridik është përgjegjës për kundërvajtje, nëse kundërvajtja është kryer nga një veprim ose mosveprim i personit juridik ose personit përgjegjës, i personit juridik ose nga akti i lejitimit të një personi tjetër i cili është i autorizuar për të vepruar në emër të personit juridik, brenda autorizimeve të tij, në mënyrë që të përfitoj për personin juridik ose personin e tretë.

2. Përgjegjësia për kundërvajtje e personit juridik nuk e përjashton përgjegjësinë e kryesit të kundërvajtjes.

Neni 24
Përgjegjësia e Personit Përgjegjës të Personit Juridik

1. Personi përgjegjës, brenda kuptimit të këtij ligji, është personi të cilit i janë besuar nga ana e personit juridik detyra të caktuara që lidhen me funksionimin, udhëheqjen apo procesin e punës. Është përgjegjës për kundërvajtje nëse ai ka kryer një kundërvajtje, gjersa mendërisht është i aftë dhe ka vepruar me dashje ose nga pakujdesia.

2. Personi përgjegjës, i cili ka vepruar me urdhër të një personi tjetër përgjegjës ose organi udhëheqës dhe që ka marrë të gjitha masat që ai është i obliguar të ndërmarrë për të parandaluar kryerjen e kundërvajtjes, nuk është përgjegjës për kundërvajtje.

Neni 25**Përgjegjësia e personit fizik, juridik dhe personit përgjegjës të huaj**

1. Personi i huaj fizik, personi i huaj juridik dhe personi përgjegjës i personit të huaj juridik, përgjigjet për kundërvajtje njësoj sikurse personi vendor fizik, juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik.
2. Personi i huaj juridik dhe personi përgjegjës për kundërvajtjen e kryer në territorin e Republikës së Kosovës do të dënohet, nëse personi i huaj juridik në Republikën e Kosovës ka njësinë afariste apo përfaqësinë.

Neni 26**Zbatimi përshtatshmërisht i Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale**

1. Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe për përgjegjësinë e personit juridik për kundërvajtje, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, me të cilat është rregulluar:

- 1.1. baza dhe kufiri i përgjegjësisë së personave juridik;
- 1.2. përgjegjësia në rast të ndryshimit të statusit dhe falimentimit të personit juridik, dhe;
- 1.3. tentativa e veprës penale.

KAPITULLI III**SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE****Neni 27****Llojet, mënyra e përcaktimit dhe shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse**

1. Për kundërvajtje mund të parashihet:
 - 1.1. qortim;
 - 1.2. gjobë;
 - 1.3. pikë ndëshkuese;
 - 1.4. pushimi i vlefshmërisë së lejes së vozitjes;
 - 1.5. ndalimi i drejtimit me automjetin;
 - 1.6. ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - 1.7. dëbimi i të huajit nga vendi.

2. Për kundërvajtje të personit juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë.

Neni 28

Kushtet për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtës

1. Gjoba parashihet dhe shqiptohet si sanksion kundërvajtës kryesor.
2. Qortimi shqiptohet në vend të gjobës kur bëhet fjalë për kundërvajtje më të lehtë.
3. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës shqiptohet vetëm nëse kryesit i është shqiptuar gjoba.
4. Pushimi i vlefshmërisë së lejes së vozitjes ose ndalimi i drejtimit të automjetit shqiptohet me gjobën, qortimin ose si sanksione të pavarur në rastet e përcaktuara me ligj.
5. Dëbimi i të huajit nga vendi shqiptohet së bashku me gjobën, qortimin ose si sanksion i vetëm në rastet e përcaktuar me ligj.

Neni 29

Sanksioni kundërvajtës me gjobë

1. Sanksioni kundërvajtës me gjobë, mund të parashihet në shumë të përcaktuar ose në shumë të caktuar.
2. Me ligj sanksioni kundërvajtës me gjobë mund të parashihet në shumë të përcaktuar dhe atë:
 - 2.1. për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik, nuk mund të jetë më pak se tridhjetë (30) euro, dhe jo më shumë se dymijë (2.000) euro;
 - 2.2. për personin fizik që ushtron biznes individual, nuk mund të jetë më pak se dyqind (200) euro, dhe jo më shumë se pesëmijë (5.000) euro;
 - 2.3. për personin juridik nuk mund të jetë më pak se pesëqind (500) euro, dhe jo më shumë se njëzetmijë (20.000) euro.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, për kundërvajtjet e lehta mund të parashihet sanksioni kundërvajtës me gjobë në shumën e përcaktuar dhe atë:
 - 3.1. për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) euro, dhe jo me shumë se dyqind (200) euro;
 - 3.2. për personin fizik që ushtron biznes individual nuk mund të jetë më pak se pesëdhjetë (50) euro, dhe jo me shumë se katërqind (400) euro;
 - 3.3. për personin juridik nuk mund të jetë më pak se njëqindpesëdhjetë (150) euro, dhe jo me shumë se dymijë (2.000) euro.

4. Me aktin e Kuvendit të Komunës sanksioni kundërvajtës mund të përcaktohet dhe atë:

4.1. për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) euro, dhe jo me shumë se njëmijë (1.000) euro;

4.2. për personin fizik që ushtron biznes individual nuk mund të jetë më pak se pesëdhjetë (50) euro, dhe jo me shumë se tremijë (3.000) euro;

4.3. për personin juridik nuk mund të jetë më pak se njëqindpesëdhjetë (150) euro, dhe jo me shumë se dhjetëmijë (10.000) euro.

5. Përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, për kundërvajtjet e lehta mund të parashihet sanksioni kundërvajtës me gjobë në shumën e përcaktuar dhe atë:

5.1. për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik nuk mund të jetë më pak se dhjetë (10) euro, dhe jo me shumë se njëqind (100) euro;

5.2. për personin fizik që ushtron biznes individual nuk mund të jetë më pak se tridhjetë (30) euro, dhe jo me shumë se dyqindpesëdhjetë (250) euro;

5.3. për personin juridik nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) euro, dhe jo me shumë se njëmijepesëqind (1.500) euro.

6. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, për kundërvajtjet nga fusha e mbrojtjes së shëndetit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së konkurrencës në treg, të mirave kulturore, të ndërtimitarisë, të informimit publik, sigurisë dhe mbrojtjes në punë, të hyrave publike dhe doganës, sanksioni kundërvajtës, me gjobë mund të dyfishohet në maksimumin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

7. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, për kundërvajtjet e kryera me qëllim të realizimit të përfitimit personal me të cilat është realizuar dobia pasurore, kryesi mund të dënohet më ashpër, e më së shumti deri në shumën e dyfishuar të paraparë me sanksionin kundërvajtës me gjobë për atë kundërvajtje.

8. Minimumet e përgjithshme të sanksionit kundërvajtës me gjobë të paraparë me këtë nen zbatohen edhe me rastin e përcaktimit të sanksionit kundërvajtës me gjobë për kundërvajtjet në bashkim.

Neni 30

Afati për pagesën e gjobës

1. Në vendimin për kundërvajtje, me të cilin përcaktohet afati i pagimit të gjobës, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, dhe më i gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e formës së prerë të vendimit, ndërsa në rastet e arsyeshme, varësisht nga lartësia e dënimit me gjobë dhe gjendja ekonomike e të pandehurit, organi i kundërvajtjes apo gjykata mund të përcaktojë që sanksioni kundërvajtës, i shqiptuar me gjobë të paguhet në këste, por që afati i pagesës nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë (6) muaj.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet e parapara me këtë ligj, mund të caktohet që sanksioni kundërvajtës, i shqiptuar me gjobë të paguhet menjëherë.

3. Në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar.

4. Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përbarim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përbarimore.

Neni 31

Rregullat e përgjithshme për matjen e sanksionit kundërvajtës

1. Gjykata do t'ia caktoj lartësinë e sanksionit kundërvajtës, kryesit duke marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, në veçanti peshën e kundërvajtjes dhe pasojat, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat dhe rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, jeta e më hershme e kryesit, gjendja e tij personale dhe qëndrimi i tij pas kundërvajtjes së kryer, gjendja e tij pasurore, si dhe rrethanat e tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryesit.

2. Nëse kundërvajtja është kryer në përsëritje, në veçanti do të merret parasysh se kundërvajtja e më hershme a është e llojit të njëjtë sikurse kundërvajtja e re, se të dy kundërvajtjet a janë kryer nga të njëjtat motive dhe sa kohë ka kaluar nga sanksioni kundërvajtës i mëhershëm.

3. Me rastin e matjes së sanksionit kundërvajtës si rrethanë rënduese nuk mund të merret parasysh sanksioni kundërvajtës i shqiptuar më herët nëse nga dita e vendimit të formës së prerë për kundërvajtje kanë kaluar më shumë se dy (2) vite.

Neni 32

Dënimi për bashkim të kundërvajtjeve

1. Nëse kryesi me një apo më shumë veprime kryen disa kundërvajtje për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari përcakton sanksionet kundërvajtëse për secilën nga këto kundërvajtje, e pastaj për të gjitha këto kundërvajtje e shqipton sanksionin kundërvajtës unik.

2. Gjykata shqipton sanksionin kundërvajtës unik sipas këtyre rregullave:

2.1. nëse për secilën kundërvajtje në bashkim është përcaktuar sanksioni kundërvajtës me gjobë, do të shqiptohet sanksioni kundërvajtës unik me gjobë, i cili paraqet grumbullin e të gjitha sanksioneve kundërvajtëse të përcaktuara, me ç'rast sanksioni kundërvajtës unik me gjobë nuk mund të kalojë shumën e dyfishit të sanksionit kundërvajtës më të lartë me gjobë të përcaktuar me këtë ligj;

2.2. nëse për kundërvajtjet në bashkim janë përcaktuar pikët ndëshkuese, do të shqiptohet sanksioni kundërvajtës unik, i cili i përgjigjet shumës së të gjitha pikëve ndëshkuese të veçanta, i cili nuk mund të jetë më shumë se 25 pikë ndëshkuese.

3. Dispozitat për bashkim të kundërvajtjeve nuk do të zbatohen për kundërvajtjet në vazhdim.

Neni 33

Sanksioni kundërvajtës për kundërvajtjen në vazhdim

1. Kundërvajtja në vazhdim është kryer kur kryesi ka kryer disa vepra të njëjta ose të ngjashme

të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim:

- 1.1. viktimës së njëjtë të kundërvajtjes;
- 1.2 .objekti i njëjtë i kundërvajtjes;
- 1.3 shfrytëzimi i situatës ose marrëdhënies së njëjtë kohore;
- 1.4. vendi ose hapësira e njëjtë e kryerjes së kundërvajtjes, dhe;
- 1.5. dashja e njëjtë e kryesit.

2. Kundërvajtjet e kryera kundër personit mund të konsiderohen si kundërvajtje në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person.

3. Kundërvajtjet në vazhdim, të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk mund të bashkohen në një kundërvajtje, nuk konsiderohen vepra penale në vazhdim.

4. Nëse kundërvajtja në vazhdim përfshinë forma të rënda dhe të lehta të të njëjtës vepër, konsiderohet se kundërvajtja në vazhdim është kryer në formën e rëndë.

5. Nëse kundërvajtja në vazhdim përfshinë kundërvajtjet element i të cilave është shuma në para, kundërvajtja në vazhdim do të përcaktohet nga shuma e tërësishme e realizuar me të gjitha kundërvajtjet e veçanta.

6. Kundërvajtja e cila nuk është përfshirë në kundërvajtje në vazhdim në aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës, por është zbuluar më vonë, paraqet kundërvajtje të veçantë.

Neni 34

Sanksioni kundërvajtës me pikë ndëshkuese

1. Për kundërvajtje kundër sigurisë në komunikacionin rrugor me ligj mund të parashihen pikët ndëshkuese prej një (1) deri në nëntë (9) pikë.

2. Sanksioni kundërvajtës nga paragrafi 1 i këtij neni shqiptohet sipas kushteve të parapara me këtë ligj, nëse me ligj tjetër nuk është paraparë ndryshe.

3. Drejtuesit të mjetit motorik, sanksioni kundërvajtës me pikë ndëshkuese mund t'i shqiptohet nëse në kohën e kryerjes së kundërvajtjes posedon patentë shofer të vlefshëm të lëshuar në Republikën e Kosovës apo drejtuesit të mjetit motorik, të cilit me vendim të formës së prerë i është ndaluar drejtimi i mjetit motorik.

Neni 35

Zbutja e sanksionit kundërvajtës

1. Nëse me rastin e caktimit të sanksionit kundërvajtës konstatohet se me kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja të rënda, ndërsa ekzistojnë rrethanat lehtësuese që vënë në dukje se

edhe me një sanksion kundërvajtës më të butë mund të arrihet qëllimi i sanksionit kundërvajtës, sanksioni kundërvajtës i dhënë mund të zbutet në njërin prej këtyre mënyrave:

1.1. të jepet sanksioni kundërvajtës nën masën minimale të dënimit që është përcaktuar për atë kundërvajtje, por jo nën masën minimale ligjore të atij lloji të sanksionit kundërvajtës.

Neni 36

Pezullimi i procedurës së kundërvajtjes nëse kompensohet dëmi

Gjykata mund të pezullojë apo të mos e fillojë procedurën e kundërvajtjes kundër kryesit të kundërvajtjes për të cilën është paraparë sanksioni kundërvajtës me gjobë, nëse kryesi në mënyrë vullnetare pas kryerjes së kundërvajtjes dhe para fillimit apo gjatë procedurës së kundërvajtjes e ka mënjeluar gjendjen kundërligjore ose e ka kompensuar dëmin të cilin e ka shkaktuar me kundërvajtje.

KAPITULLI IV MASAT MBROJTËSE

Neni 37

Lloji i masave mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse të cilat mund të parashihen vetëm me ligj janë, si vijon:

1.1. konfiskimi i sendit;

1.2. ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, aktivitetit ose detyrës.

2. Masat mbrojtëse nga paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 i këtij neni, në kushtet e parashikuara me këtë ligj, mund të jepen edhe kur nuk janë përcaktuar për kundërvajtje.

3. Masat mbrojtëse nga paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 i këtij neni mund të jepen edhe nëse sanksioni kundërvajtës nuk është dhënë, por kur mundësia e këtillë është parashikuar me ligj.

KAPITULLI V MASAT E VEÇANTA TË KUNDËRVAJTJES

Neni 38

Konfiskimi i pasurisë dhe i dobisë pasurore dhe marrja e sendit

1. Sendet që janë përdorë ose kanë qenë të destinuara për kryerjen e kundërvajtjes, ose që kanë lindur me kundërvajtjen e bërë mund të merren, nëse janë pronë e kryesit të kundërvajtjes.

2. Sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren edhe kur nuk janë pronë e kryesit të kundërvajtjes ose nuk i disponon ato personi juridik, nëse këtë gjë e kërkon interesi i sigurisë

së përgjithshme, ruajtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, siguria e qarkullimit të mallrave ose arsyet e moralit publik, si dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

3. Organi i cili e ka marrë vendimin mbi kundërvajtjen cakton se sendet e marra, a do të asgjësohen, a do të shiten, ose a do ti dorëzohen organit respektivisht personit të interesuar.

4. Me marrjen e sendeve nuk preket e drejta e personit të tretë për kompensimin e dëmit nga kryesi.

5. Prej kryerësit do të merren të hollat, sendet me vlerë dhe çdo përfitim tjetër pasuror, që ka përfituar nga kundërvajtja. Nëse marrja është e pamundur, do të obligohet kryerësi që ta paguajë shumën në të holla që i përgjigjet përfitimit pasuror.

6. Nëse i ndëshkuari, brenda afatit të caktuar, nuk e paguan shumën në të holla nga paragrafi 5 i këtij neni do të ekzekutohet arkëtimi me dhunë. Përfitimi pasuror me kundërvajtjen mund të merret prej personave të cilëve u është bartur pa kompensim ose me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse ata e kanë ditur ose kanë mundur ta dinë se përfitimi pasuror është vënë me dorë me anë të kundërvajtjes.

7. Kur përfitimi pasuror u është bartur të afërmeve të kryesit, do të merret prej tyre nëse nuk e argumentojnë se për kompensimin nuk e kanë dhënë vlerën e plotë.

Neni 39

Konfiskimi i pasurisë dhe i dobisë pasurore

1. Sendet që janë përdor ose kanë qenë të destinuara për kryerjen e kundërvajtjes ose që janë krijuar me kundërvajtjen e kryer mund të konfiskohen nëse janë pronë e kryesit.

2. Sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryesit, nëse këtë e kërkojnë arsyet e mbrojtjes së sigurisë së përgjithshme, shëndetit të njerëzve apo të pasurisë, arsyet e moralit apo kur edhe më tej ekziston rreziku se do të përdoren për kryerjen e kundërvajtjes, por në atë mënyrë nuk preken të drejtat e personave të tretë në kompensimin e dëmit nga kryesi.

3. Gjykata e cila ka nxjerr vendimin, në pajtim me dispozitat e veçanta, do të përcaktojë se sendet e konfiskuara a do të asgjësohen, shitën apo i dorëzohen organit, përkatësisht organizatës së interesuar.

Neni 40

Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës

1. Masa e dëbimit të të huajit nga territori i Republikës së Kosovës mund t'i shqiptohet të huajit, i cili është ndëshkuar për kundërvajtje për shkak të së cilës qëndrimi i tij i mëtejshëm në Republikën e Kosovës është në kundërshtim me Ligjin për të huajt.

2. Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh deri në tri (3) vjet. Kohëzgjatja e masës së dhënë fillon nga data kur vendimi për kundërvajtje ka marr formën e prerë.

KAPITULLI VI TË DHËNAT NGA EVIDENCA E KUNDËRVAJTJES

Neni 41 Evidenca e kundërvajtjes

1. Evidenca e kundërvajtjes përmban të dhënat si vijon:
 - 1.1. të dhënat personale për kryesin;
 - 1.2. të dhënat për kundërvajtjen;
 - 1.3. të dhënat për sanksionet dhe të dhënat për pasojat juridike të sanksionit kundërvajtës, ndryshimet e mëvonshme për të dhënat e përmbajtura në evidencë.
2. Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet në formë elektronike.
3. Të dhënat nga evidenca e kundërvajtjes mund t'u jepen:
 - 3.1. gjykatës, prokurorit të shtetit dhe parashtruesve të autorizuar të kërkesave, nëse ka të bëjë me procedurën e kundërvajtjes kundër kryesit për të cilin kërkohen të dhënat, si dhe organit të kujdestarisë apo organit tjetër kompetent kur kjo është e nevojshme për kryerjen e punëve nga kompetenca e tij;
 - 3.2. organeve tjera, shoqërive tregtare dhe personit tjetër juridik me kërkesë të arsyetuar, nëse ende zgjatin pasojat juridike të sanksionit kundërvajtës dhe nëse për atë ekziston interesi i arsyeshëm i bazuar në ligj.
4. Me evidencën e kundërvajtjes mund të shërbehet edhe organi kompetent për punët e policisë në kuadër të autorizimeve të tij ligjore, me qëllim të zbulimit të kryesit të kundërvajtjes. Të dhënat e theksuara konsiderohen sekret zyrtar.
5. Shtetasit, me kërkesën e tij mund t'i jepen të dhënat për sanksionin kundërvajtës.
6. Askush nuk është i detyruar të paraqes prova se është ose nuk është i dënuar për kundërvajtje.
7. Evidencën e kundërvajtjes, të shqiptuar nga gjykatat, e mban Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Mënyra e mbajtjes përcaktohet me akt nënligjor nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

KAPITULLI VII PARASHKRIMI

Neni 42 Parashkrimi i zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes

1. Procedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon një (1) vit nga data kur është kryer kundërvajtja.

2. Nuk rrjedhë parashkrimi i ndjekjes gjatë kohës për të cilën ndjekja sipas ligjit nuk mund të ndërmerret.

3. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ndërmerret për ndjekjen e kryesit të kundërvajtjes.

4. Me çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, por parashkrimi bëhet në çdo rast kur kalojnë dy (2) vjet nga data kur është kryer kundërvajtja.

5. Me ligj për kundërvajtjet e caktuara mund të caktohen afatet e parashkrimit më të gjata se afatet nga paragrafi 1 i këtij neni, por jo më të gjata se pesë (5) vjet.

Neni 43

Parashkrimi i ekzekutimit

1. Sanksioni i shqiptuar i kundërvajtjes nuk mund të ekzekutohen nëse nga data kur vendimi mbi kundërvajtjen ka marrë formën e prerë ka kaluar një (1) vit.

2. Parashkrimi i ekzekutimit të sanksionit kundërvajtës fillon të rrjedhë nga dita kur vendimi për kundërvajtje është bërë i formës së prerë.

3. Parashkrimi nuk rrjedhë gjatë kohës për të cilën sipas ligjit ekzekutimi nuk mund të ndërmerret.

4. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ndërmerret për ekzekutimin e sanksionit të kundërvajtjes.

5. Pas çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri.

6. Parashkrimi i sanksionit kundërvajtës bëhet në çdo rast kur kalojnë dy herë më shumë kohë se sa sipas ligjit kërkohet për parashkrimin e ekzekutimit.

7. Me ligj, për kundërvajtjet e caktuara mund të caktohen edhe afatet më të gjata të parashkrimit të ndjekjes për kundërvajtje dhe ekzekutimit të ndëshkimeve të kundërvajtjes, respektivisht të masave mbrojtëse.

KAPITULLI VIII MASAT EDUKATIVE

Neni 44

Llojet e masave edukative

1. Të miturit, i cili në kohën e kryerjes së kundërvajtjes ka mbushur moshën 14 vjeç mund t'i jepen këto masa edukative:

1.1. qortimi, dhe;

1.2. mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindërve, e kujdestarit ose e organit të kujdestarisë.

2. Masa edukative e mbikëqyrjes së shtuar do t'i jepet të miturit nëse është e nevojshme që të merren masat e përhershme të edukimit dhe të përmirësimit. Kjo masë mund të zgjasë më së shumti derisa të mbushë moshën madhore.

3. Para dhënies së masës edukative të të miturit, do të merret mendimi i organit kompetent të kujdestarisë.

4. Nëse i mituri është bërë madhor para se të merret vendimi për kundërvajtjen, nuk do të jepet masa edukative, e nëse i mituri është bërë madhor pas marrjes së vendimit për kundërvajtjet, masa edukuese e dhënë do të ekzekutohet.

Neni 45

Zbatimi përshtatshmërisht i legjislacionit për kundërvajtje ndaj të miturit

Ndaj kryesve të mitur të kundërvajtjeve, zbatohen dispozitat materialo-juridike të këtij ligji, përveç nëse me dispozitat e këtij kapitulli nuk është përcaktuar ndryshe.

PJESA E DYTË

PROCEDURA E KUNDËRVAJTJES

KAPITULLI IX

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 46

Qëllimi i dispozitave të përgjithshme

1. Me dispozitat e përgjithshme të këtij ligji, mundësohet zhvillimi i drejtë i procedurës së kundërvajtjes, mbrojtja e të drejtave të njeriut, konstatimi i drejtë dhe i plotë i fakteve dhe vendosja e ligjshme për përgjegjësin e kundërvajtjes, ashtu që askush i pafajshëm të mos gjykohej, ndërsa kryesit të kundërvajtjes t'i shqiptohet sanksioni apo ndaj tij të zbatohet sanksioni tjetër i kundërvajtjes.

2. Para nxjerrjes së vendimit të formës së prerë për kundërvajtje të pandehurit mund t'i kufizohet realizimi i lirive dhe të drejtave vetëm nën kushtet e parapara me këtë ligj.

3. Nëse me këtë ligj nuk janë rregulluar disa çështje të procedura të kundërvajtjes, në ato çështje përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Kodit për procedurën penale.

Neni 47

Të provuarit

1. Provat mblidhen në pajtim me këtë ligj.

2. Barra e të provuarit të kundërvajtjes dhe të përgjegjësisë së kundërvajtjes është në paraqitësin e kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes.

3. Gjykata provat i nxjerr me propozimin e palëve. Pala duhet t'i paraqesë provat të cilat i ka

propozuar.

4. Përjashtimisht, gjykata sipas detyrës zyrtare mund t'i administrojë provat në dobi të të pandehurit, nëse nuk është në gjendje që atë vetë ta bëjë ose nëse ajo është e arsyeshme nga arsyet e përshtatshmërisë dhe efikasitetit të zhvillimit të procedurës.

Neni 48

E drejta në mbrojtje, qasja në dokumente dhe në përkthim

1. Para se të merret vendimi për kundërvajtjen, të pandehurit do t'i jepet mundësia që të deklarohet lidhur me faktin çka i vihet në barrë.

2. Nëse i pandehuri i thirrur në mënyrë të rregullt nuk paraqitet që të merret në pyetje dhe nuk e arsyeton mungesën, kurse marrja e tij në pyetje nuk është e domosdoshme për konstatimin e fakteve të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, vendimi për kundërvajtjen mund të merret edhe pa marrjen në pyetje të të pandehurit.

3. I pandehuri ka të drejtë që të mbrohet vetë apo me ndihmën profesionale të mbrojtësit të cilin vetë e zgjedh. Me rastin e dëgjimit të parë të pandehurit, gjykata duhet ta udhëzojë me shkrim ose gojarisht të pandehurin për këto të drejta procedurale: për të drejtën në mbrojtje, ndihmën juridike falas, të drejtën për t'u informuar për shkeljen e kundërvajtjes menjëherë dhe deri në atë masë që të sigurohet ndershmëria e procesit dhe zbatimi efektiv i të drejtës në mbrojtje të drejtën në përkthim dhe interpretim, si dhe të drejtën për tu mbrojtur në heshtje. Gjukata duhet të informoj menjëherë të pandehurin për çdo ndryshim lidhur me informatat të cilat i pandehuri më parë i ka pranuar.

4. Për të pandehurin i cili nuk ka aftësi procedurale, veprimet në procedurë i ndërmerr përfaqësuesi ligjor.

5. Gjukata paraprakisht duhet të sigurohet se i pandehuri e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

6. I pandehuri ka të drejtë që në procedurën e kundërvajtjes të përdor gjuhën e vet, përkatësisht t'i sigurohet përkthimi kualitativ në gjuhën të cilën e kupton. Në rast se është e nevojshme, me qëllim të mbarëvajtjes së procedurës, përkthimi duhet të sigurohet edhe në komunikim në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij ligjor.

7. Me qëllim që të sigurohet e drejta në mbrojtje dhe mbarëvajtja e procedurës, gjykata duhet ti siguroj të pandehurit në gjuhën që e kupton përkthimin kualitativ me shkrim të të gjitha vendimeve esenciale që merren në procedurën e kundërvajtjes, duke përfshirë aktgjykimet. Në të gjitha rastet e tjera, gjykata vlerëson në mënyrë diskrecionale për përkthimin e vendimeve të tjera. I pandehuri ose përfaqësuesi i tij ligjor mund të parashtrojnë kërkesë të arsyetuar për përkthimin e ndonjë vendimi, të cilin ata e konsiderojnë të nevojshëm.

8. Nuk duhet të ketë detyrim për gjykatën që të ofrojë përkthimin e paragrafëve të vendimit të cilat nuk janë relevante dhe nuk e dëmtojnë të pandehurin. Në raste të caktuara përkthimi nga ky paragraf mund të ofrohet edhe gojarisht me kusht që mos të pengohet ndershmëria e procesit.

9. Në rast se i pandehuri është i shurdhër ose memec, të njëjtit i sigurohet ndihmë adekuate nga gjykata, për të kuptuar rrjedhën e procedurës.

10. Shërbimet nga paragrafi 6, 7 dhe 8 të këtij neni, mund të ofrohen edhe përmes teknologjisë informative, përveç rasteve kur prezenca fizike e përkthyesit ose interpretit është e nevojshme për mbarëvajtjen e procedurës.
11. I pandehuri mund të heqë dorë nga të drejtat e tij të parapara në paragrafin 6 dhe 7, me kusht që heqja dorë të bëhet me shkrim, në mënyrë vullnetare dhe pasi të jetë informuar më parë për të drejtat e tij dhe pasojat e këtij veprimi.
12. Shpenzimet e përkthimit nuk i ngarkohen të pandehurit i cili nuk e di ose nuk e flet gjuhën në të cilën zbatohet procedura e kundërvajtjes.
13. Përkthyesi për veprimet e përkthimit të ndërmarra në procedurën kundërvajtëse, obligohet të ruaj konfidencialitetin.
14. Veprimet e ndërmarra nga ky nen shënohen në procesverbal.
15. Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, lidhur me të drejtat e të pandehurit në procedurë kundërvajtëse, zbatohen përshtatshëm dispoziat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 49

Vlerësimi i lirë i provave

1. Gjykata vlerëson provat sipas bindjes së vet të lirë. Se cilat fakte do t'i merr si të argumentuara vendosë gjykata për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes në bazë të vlerësimit të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në bazë të rezultatit të procedurës së tërësishme.
2. Vendimi i gjykatës, nuk mund të bazohet në provat të cilat janë nxjerrë me shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë apo me marrëveshje ndërkombëtare të pranuar.

Neni 50

Efikasiteti i procedurës së kundërvajtjes

Procedura e kundërvajtjes zhvillohet në mënyrë të shpejtë dhe të shkurtër, por kjo të mos jetë në dëm të vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Neni 51

Parimi i së vërtetës

Gjykata është e detyruar që saktësisht dhe në mënyrë të plotë t'i konstatoj të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë për kundërvajtjen, si dhe me kujdes të barabartë t'i provoj dhe verifikoj faktet që e ngarkojnë të pandehurin, si dhe faktet që i shkojnë në favor.

Neni 52**Ndalimi i gjykimit të përsëritur**

1. Askush përsëri nuk mund të gjykohet për kundërvajtje për të cilën me vendimin e formës së prerë është gjykuar apo liruar.
2. Ndalesa nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e pengon përsëritjen e procedurës së kundërvajtjes në pajtim me këtë ligj.
3. Personi, i cili në procedurën penale me vendim të formës së prerë është shpallur fajtor për veprë penale e cila ka elemente të kundërvajtjes nuk do të dënohet për kundërvajtje.

Neni 53**Udhëzimi për palën e padijshme**

I pandehuri apo personi tjetër që merr pjesë në procedurë kundërvajtëse, ndërsa nga mosdija do të mund të lëshonte ndonjë veprim apo për shkak të kësaj nuk i shfrytëzon të drejtat e veta, gjykata do ta udhëzojë për të drejtat të cilat me këtë ligj i takojnë, si dhe për pasojat e lëshimit të veprimit.

Neni 54**Dyshkallësia e procedurës së kundërvajtjes**

Kundër vendimit të nxjerrë në shkallën e parë mund të paraqitet ankesa, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

KAPITULLI X**KOMPETENCA DHE PËRJASHTIMI****Neni 55****Kompetenca lëndore dhe përbërja e gjykatës**

1. Gjykata gjykon në kufijtë e kompetencës së saj lëndore të paraparë me ligj.
2. Procedurën e kundërvajtjes në shkallë të parë e udhëheq gjyqtari individual.
3. Gjykata e shkallës së dytë vendos në kolegjin prej tre (3) gjyqtarëve.
4. Për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet, dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptoj organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike (në tekstin e mëtejme: organi për kundërvajtje) të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje.
5. Kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje të nxjerrë nga organet e parapara në paragrafin 4 të këtij neni garantohet mbrojtje gjyqësore.

Neni 56

Kompetenca e organit kundërvajtës

1. Organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj.
2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni organi për kundërvajtje është kompetent që të veproj sipas të gjitha kundërvajtjeve:
 - 2.1. për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar;
 - 2.2. për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në pesëqind (500) euro;
 - 2.3. për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik gjoba deri në një mijë (1.000) euro, dhe;
 - 2.4. për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend.

Neni 57

Konflikti i kompetencave

Me konfliktin e kompetencave në mes të gjykatave dhe organeve të kundërvajtjes vendos gjykata kompetente për vendosje sipas konfliktit administrativ.

Neni 58

Vendimi

Për kundërvajtje dhe për shqiptimin e sanksionit të kundërvajtjes vendos gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes me vendim, kundër të cilave lejohen mjetet juridike të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 59

Shpenzimet e procedurës

Shpenzimet e procedurës janë shpenzimet të cilat shkaktohen në procedurën e kundërvajtjes ose për shkak të saj edhe shpenzimet të cilat krijohen lidhur me sigurimin e provave të nevojshme dhe ruajtjen e sendeve të sekuestruara dhe të konfiskuara para zhvillimit të procedurës.

KAPITULLI XI

PROCEDURA E KUNDËRVAJTJES PARA ORGANIT TË KUNDËRVAJTJES

Neni 60

Autorizimet për zhvillimin e procedurës

1. Në rast se pala parashtron kundërshtimin ndaj sanksionit kundërvajtës, procedura zhvillohet pranë organit të kundërvajtjes nga komisioni për vendosje, në përbërje prej së paku tre (3)

anëtarëve. Parashtrimi i kundërshtimit duhet të bëhet brenda tetë (8) ditëve dhe i njëjti shtyn ekzekutimin për pagimin e gjobës në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Anëtarët e komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni janë personat zyrtarë të autorizuar me shkallën përkatëse të përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës të nevojshme, nga të cilët së paku një nga anëtarët të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës.

Neni 61

Zhvillimi i procedurës së kundërvajtjes

1. Organi i kundërvajtjes e zhvillon procedurën e kundërvajtjes sipas detyrës zyrtare, me kërkesën e personit zyrtar të autorizuar ose me kërkesë të organit të autorizuar nga neni 86 i këtij ligji dhe nga i dëmtuari (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës).

2. Kërkesa për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes i përmban të dhënat nga neni 87 i këtij ligji.

3. Kërkesa i paraqitet organit kompetent të kundërvajtjes. Nëse kërkesa i është paraqitur organit tjetër, ai menjëherë ia dërgon organit kompetent për kundërvajtje dhe për atë e informon paraqitësin e kërkesës.

Neni 62

Vendimi sipas kërkesës për zhvillimi e procedurës së kundërvajtjes

1. Organi i kundërvajtjes pas vërtetimit të kushteve për zhvillimin e procedurës sipas detyrës zyrtare, përkatësisht sipas kërkesës nga neni 86 i këtij ligji, në mënyrë plotësuese do të administroj informacionet dhe provat për kundërvajtjen.

2. Nëse organi i kundërvajtjes vërteton se ekzistojnë kushtet ligjore për zbatimin e procedurës së kundërvajtjes, është i detyruar që ta zbatojë dhe të nxjerrë vendim për kundërvajtje.

3. Nëse procedura nuk është në kompetencë të organit të kundërvajtjes, organi i kundërvajtjes është i detyruar që gjykatës kompetente t'i paraqes kërkesë për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes.

4. Organi i kundërvajtjes nuk do të nxjerrë vendim për kundërvajtje, përkatësisht nuk do të paraqes kërkesë për zhvillim të procedurës së kundërvajtjes tek gjykata kompetente, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet nga nenin 56, paragrafi 2 i këtij ligji.

5. Vendimet nga paragrafi 4 i këtij neni dhe arsyet shënohen në shkresë.

6. Organi i kundërvajtjes është i obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh me shkrim ta informojë paraqitësin e kërkesës për vendimin që mos të nxirret vendimi për kundërvajtje, përkatësisht të mos paraqitet kërkesa për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes në gjykatën kompetente, si dhe për arsyet e vendimit.

Neni 63

Zbatimi përshtatshmërisht i dispozitave të Ligjit për procedurën administrative

Organi i kundërvajtjes me rastin e zhvillimit të procedurës së kundërvajtjes, përshtatshmërisht i zbaton dispozitat e Ligjit për procedurën administrative, përveç nëse me këtë ligj dhe me ligjin me të cilin është paraparë kundërvajtja nuk është përcaktuar ndryshe.

KAPITULLI XII

MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 64

E drejta në zhvillimin e konfliktit administrativ

1. Kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje, të cilën e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes, mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ. Padinë mund ta paraqes personi (fizik ose juridik), ndaj të cilit i është shqiptuar sanksioni, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij, si dhe pronari i sendit të konfiskuar/marrë dhe në procedurën e kundërvajtjes.

2. Padia nga paragrafi 1 i këtij neni e shtyn ekzekutimin e vendimit për pagimin e gjobës, përveç nëse gjoba e shqiptuar me vendim dhe shpenzimet e procedurës në përgjithësi për personin fizik nuk tejkalojnë njëqind (100) euro, për personin përgjegjës në personin juridik, personin zyrtar ose për biznes individual pesëqind (500) euro dhe për personin juridik njëmijë (1.000) euro.

3. Me propozimin e paditësit të paraqitur së bashku me padinë e gjykatës, e cila është kompetente që të vendos për kontestin administrative, me vendim të veçantë do të ndalojë ekzekutimin e vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni deri kur bëhet i formës së prerë, nëse paraqitësi i padisë dëshmon se për shkak të ekzekutimit do të shkaktohet dëmi i pa kompenzueshëm.

4. Gjykata kompetente që të vendosë për konfliktin administrative procedurën e mbrojtjes gjyqësore e zhvillon sipas Ligjit për Konfliktet Administrative.

Neni 65

Afati për paraqitjen e padisë dhe kompetenca

1. Padia nga neni paraprak i këtij ligji paraqitet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit për kundërvajtje.

2. Sipas padisë vendosë gjykata kompetente për vendosje në konfliktin administrativ.

Neni 66

Arsyet për paraqitjen e padisë

1. Vendimi i organit kundërvajtës mund të kontestohet me padi:

1.1. nëse me vendim ka qenë shkelur dispozita materiale e ligjit, me të cilën është paraparë kundërvajtja;

1.2. nëse janë shkelur dispozitat e procedurës, sepse nuk ka vendosur organi kompetent ose nëse vendimi nuk i ka të gjitha elementet përbërëse të parapara;

1.3. për shkak të përcaktimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me ç'rast në padi nuk mund të theksohen faktet e reja dhe të propozohen prova të reja, nëse paditësi gjen se me siguri pa fajin e tij nuk ka qenë e mundshme që t'i propozojë në procedurë, dhe;

1.4. për shkak të sanksioneve të shqiptuara, konfiskimit të sendeve dhe shpenzimeve të procedurës.

Neni 67 **Përfundimi**

Gjyqtari, i cili merr pjesë në procedurë do të përfundohet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesën e palëve, mbrojtësit apo të dëmtuarit, kur ekziston ndonjëra nga bazat për përfundim.

Neni 68 **Zbatimi supsidiar**

Lidhur me kompetencën territoriale tokësore, bashkimit apo ndarjes së procedurës për kundërvajtje, bartjes së kompetencës territoriale, vlerësimit dhe konfliktit të kompetencës, përfundimit, si dhe çështjet e tjera lidhur me të, përshtatshëm zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, nëse me këtë ligji nuk është caktuar ndryshe.

KAPITULLI XIII **I PANDEHURI DHE I DËMTUARI NË PROCEDURË NË GJYKATË**

Neni 69 **I pandehuri dhe të drejtat e tij**

1. I pandehuri është personi kundër të cilit zhvillohet procedura e kundërvajtjes.
2. I pandehuri ka të drejtë të paraqes prova, të bëjë propozime dhe t'i përdorë mjetet juridike të parashikuar me këtë ligj.
3. I pandehur ka të drejtë, të mbrohet vetë ose me ndihmën profesionale të mbrojtësit.
4. Për mbrojtës mund të angazhohet avokati ndërsa atë mund ta zëvendësoj avokati praktikant.
5. Për të pandehurin, i cili nuk ka aftësi procedurale, veprimet në procedurë i ndërmerr përfaqësuesi ligjor.
6. Mbrojtësi është i autorizuar që në favor të të pandehurit t'i ndërmerr të gjitha veprimet që mund t'i ndërmerr i pandehuri.
7. Mbrojtësi është i obliguar që t'ia paraqes prokurën gjykatës ose organit, para të cilit zhvillohet

procedura e kundërvajtjes. I pandehuri, mbrojtësit mund t'i jap autorizimin edhe gojarisht në procesverbal.

8. Të drejtat dhe detyrat e mbrojtësit pushojnë kur heq dorë nga autorizimi apo kur i pandehuri revokon autorizimin.

Neni 70

Përfaqësuesi i personit të pandehur juridik

1. Për personin e pandehur juridik në procedurën e kundërvajtjes merr pjesë përfaqësuesi i tij, i cili është i autorizuar që t'i ndërmerr të gjitha veprimet në emër të personit të pandehur juridik që mund t'i ndërmerr i pandehuri.

2. Përfaqësuesi i personit të pandehur juridik është personi i cili është i autorizuar ta përfaqësojë atë person juridik në bazë të ligjit apo të aktit tjetër.

3. Përfaqësuesi i personit të pandehur juridik nga paragrafi 2 i këtij neni, duhet ta ketë autorizimin me shkrim të organit, i cili e ka caktuar përfaqësues.

4. Përfaqësuesi i personit të pandehur juridik mund të jetë vetëm një person.

5. Personi i pandehuri juridik dhe personi i pandehur përgjegjës mund ta këtë secili mbrojtësin e vet ose mund ta kenë mbrojtësin e përbashkët. Mbrojtës i personit juridik dhe i personit përgjegjës në atë person juridik, nuk mund të jetë personi i cili në procedurën e njëjtë të kundërvajtjes ka pasur cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik.

Neni 71

Përfaqësuesi i personit të huaj të pandehur juridik

1. Nëse nuk është caktuar ndryshe në dispozitën me të cilën është parashikuar kundërvajtja, personi i huaj juridik dhe personi i huaj përgjegjës do të ndëshkohet për kundërvajtje, nëse kundërvajtja është kryer në territorin e Republikës së Kosovës dhe nëse personi i huaj juridik e ka njësinë afariste në territorin e Republikën e Kosovës.

2. Përfaqësuesi i personit të huaj të pandehur juridik është personi i cili administron me përfaqësinë apo me njësinë tjetër afariste të atij personi juridik në Republikën e Kosovës, nëse përfaqësues nuk është caktuar personi tjetër.

Neni 72

Personi i cili nuk mund të jetë përfaqësues i personit juridik

1. Përfaqësues i personit juridik nuk mund të jetë personi i cili:

1.1. është dëshmitar në çështjen e njëjtë;

1.2. personi përgjegjës kundër të cilit zhvillohet procedura për kundërvajtjen e njëjtë, përveç, nëse ai deklaron se ka vepruar në bazë të urdhrit të personit tjetër përgjegjës ose organit menaxhues.

2. Në rastet, nga paragrafi 1 i këtij neni gjyqtari është i detyruar ta informojë personin juridik që në afat prej tetë (8) ditësh ta caktoj përfaqësuesin tjetër.

3. Nëse personi juridik i pandehur nuk e cakton përfaqësuesin tjetër në afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, do të dënohet me dënim me gjobë deri në pesëqind (500) euro. Nëse edhe pas ndëshkimit të dhënë personi juridik nuk e cakton personin e vet, për çdo mos përgjigje tjetër për caktimin e përfaqësuesit do të ndëshkohet me gjobë deri në njëmijë (1000) euro.

Neni 73 **I dëmtuari**

1. Në kuptim të këtij ligji, i dëmtuar është personi të cilit i është shkelur ose rrezikuar me kundërvajtje ndonjë e drejtë personale ose pasurore.

2. I dëmtuari ka të drejtë që vetë ose nëpërmjet të përfaqësuesit ligjor ose të autorizuarit:

2.1. të paraqet dhe përfaqëson kërkesën, për fillimin e procedurës për kundërvajtje;

2.2. të paraqet prova, të bëjë propozime dhe të ushtrojë kërkesën pasurore juridike për kompensimin e dëmit ose për kthimin e sendit;

2.3. të paraqet ankesë kundër vendimit që është marrë lidhur me kërkesën e tij për fillimin e procedurës së kundërvajtjes;

2.4. të paraqes prova në bazë të të cilave gjykata mundet që të pandehurit t'i ndaloj që t'i ofrohet objektit të dëmtuar ose vendit të kryerjes së kundërvajtjes gjatë procedurës.

KAPITULLI XIV **KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME**

Neni 74 **Afati për kthim në gjendje të mëparshme**

1. Të pandehurit ose paraqitësit të autorizuar për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes, i cili për shkaqe të arsyeshme e lëshon afatin që ta paraqes ankesën kundër vendimit për kundërvajtjen do t'i lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, nëse brenda afatit prej tri (3) ditësh nga data e pushimit të shkakut për ç'arsye është lëshuar afati, e paraqet kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme dhe nëse në të njëjtën kohë bashkë me kërkesën e dorëzon edhe ankesën.

2. Pas kalimit të një muaji nga data e afatit të lëshuar nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

3. Kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme i dorëzohet gjykatës të cilës i dorëzohet ankesa.

4. Kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit për kundërvajtjen, por organi kompetent për vendosje lidhur me kërkesën sipas rrethanave mund të vendosë që të shtyhet ekzekutimi, derisa të merret vendimi sipas kërkesës.

Neni 75

Vendosja për kthim në gjendje të mëparshme

1. Për kthimin në gjendjen e mëparshme vendosë gjykata kompetente për marrjen e vendimit që atakohet me ankesë.
2. Kundër vendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet ankesa.

KAPITULLI XV

SHPENZIMET E PROCEDURËS SË KUNDËRVAJTJES DHE PËR KËRKESAT PASURORE JURIDIKE

Neni 76

Zbatimi subsidiar

Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për shpenzimet e procedurës dhe shpenzimet për kërkesat pasurore juridike përshtatshëmrisht zbatohen edhe në procedurën e kundërvajtjes.

KAPITULLI XVI

MARRJA E VENDIMEVE DHE KOMUNIKIMI I TYRE

Neni 77

Llojet dhe komunikimi i vendimeve

1. Vendimet në procedurën e kundërvajtjes gjykata i merr në formë të:
 - 1.1. aktgjykimit;
 - 1.2. aktvendimit, dhe;
 - 1.3. urdhëresës.
2. Vendimi sipas rregullit komunikohen menjëherë pasi që të merren, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.
3. Vendimi i cili është komunikuar duhet të hartohet në formën me shkrim në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e komunikimit me gojë, ndërsa dërgimi i vendimit bëhet menjëherë, nëse para marrjes së formës së prerë përcaktohet ekzekutimi i vendimit.
4. Vendimi u komunikohen personave të interesuar me gojë nëse janë të pranishëm, kurse me dërgimin e kopjes së vërtetuar nëse nuk janë të pranishëm.
5. Kur vendimi është komunikuar me gojë, kjo gjë do të shënohet në procesverbal, kurse personi të cilit i është bërë komunikimi do ta vërtetojë këtë me nënshkrimin e vet.

6. Me kërkesën e personit të interesuar do të jepet kopja me shkrim e vendimit të komunikuar me gojë. Kur personi i interesuar kërkon kopjen e vendimit, afati për ankesë llogaritet nga data e dërgimit të kopjes së vërtetuar të vendimit.

Neni 78

Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë

1. Vendimet e kolegjit merren pas diskutimit verbal dhe votimit. Vendimi është marrë kur për këtë ka votuar shumica e anëtarëve të kolegjit.

2. Kryetari i kolegjit e udhëheq diskutimin dhe votimin dhe ai voton i fundit. Ai është i detyruar të kujdeset që të gjitha çështjet të shqyrtohen në mënyrë të gjithanshme dhe të plotë.

3. Anëtarët e kolegjit nuk mund të refuzojnë të votojnë lidhur me çështjet që i shtron kryetari i kolegjit, por anëtari i kolegjit, i cili ka votuar që të pezullohet procedura e kundërvajtjes dhe ka mbetur në pakicë, nuk është i detyruar që të votojë lidhur me ndëshkimin, e nëse nuk voton do të konsiderohet se është pajtuar me votën, e cila është me e favorshme për të pandehurin.

4. Kur votat për ndonjë çështje individuale për të cilën duhet votuar ndahen në disa mendime të ndryshme, kështu që asnjëri prej tyre nuk e ka shumicën, çështjet ndahen dhe votimi përsëritet, derisa të arrihet shumica e votave. Nëse edhe në këtë mënyrë nuk arrihet shumica e votave, vendimi do të merret në atë mënyrë që votat që janë më të disfavorshme për të pandehurin, do të numërohen me votat të cilat janë më pak të favorshme se këto, gjithnjë, derisa të arrihet shumica e nevojshme e votave.

5. Gjatë diskutimit dhe votimit mund të jenë të pranishëm vetëm anëtarët e kolegjit dhe procesmbajtësi.

KAPITULLI XVII DËRGIMI I SHKRESVE

Neni 79

Mënyra e dërgimit

1. Shkresat dërgohen me anë të postës ose nëpërmjet shërbimit tjetër të autorizuar për dërgim, të personit zyrtar të gjykatës apo të organit tjetër ose drejtpërdrejt në lokalet e gjykatës. Dërgimi mund të bëhet edhe në formën elektronike, në pajtim me dispozitat e veçanta.

2. Letërthirrjet për marrjen në pyetje ose për hetim, respektivisht për dhënien e mbrojtjes me shkrim, si dhe të gjitha vendimet nga dërgimi i të cilave rrjedhë afati për ankesë, i dërgohen personalisht të pandehurit. Në të njëjtën mënyrë i dërgohen vendimet të dëmtuarit për të cilët nga data e dërgimit rrjedhë afati për ankesë.

3. Dërgimi i shkresave bëhet për çdo ditë pune në vendin e punës apo lokalin afarist në kohën e orarit të punës, ose në banesë prej orës tetë (8) deri në ora njëzetedy (22), ose në gjykatë kur personit të cilit duhet t'i bëhet dorëzimi gjendet atje apo kur gjykata e thërret për t'ia dorëzuar.

4. Nëse personi të cilit duhet t'i dorëzohet patjetër shkresa nuk gjendet atje ku duhet të bëhet dorëzimi, dorëzuesi do t'ia lë te njëri prej personave të përmendur në nenin 80 të këtij ligji

njoftimin me shkrim që për marrjen në dorëzim të shkresës në ditën dhe në orën e caktuar të jetë në banesën e vet, respektivisht në vendin e vet të punës. Nëse edhe pas këtij veprimi dërguesi nuk e gjen personin të cilit duhet t'i bëhet dorëzimi, do të veprojë sipas dispozitës së nenit 80, paragrafi 1 i këtij ligji dhe kështu konsiderohet se është bërë dorëzimi.

5. Organit shtetëror vendimet dhe shkresat e tjera i dërgohen me anë të dorëzimit në shkrimore.

6. Dërgimi i shkresave personave juridik bëhet me dorëzimin e tyre personit të autorizuar për pranimin e shkresave apo personin tjetër i cili punon për personin juridik.

7. Kur bëhet dorëzimi i vendimeve të cilët rrjedh afati nga data e dorëzimit, si datë e dorëzimit konsiderohet data e dorëzimit shkrimores, respektivisht personit të përmendur në paragrafin 6 të këtij neni.

Neni 80

Dorëzimi personal i detyrueshëm

1. Shkresat që nuk janë shënuar në nenin 79, paragrafin 2 të këtij ligji dërgohen personalisht, por shkresat e këtilla në rastin kur marrësi nuk gjendet në banesë mund t'i dorëzohen ndonjërit prej anëtarëve të rritur të familjes. Nëse ata nuk gjenden në banesë, shkresa i dorëzohet fqijut nëse ai pajtohet për këtë gjë. Nëse dorëzimi bëhet në vendin e punës personit të cilit duhet t'i dorëzohet shkresa, e ky person nuk gjendet aty, dorëzimi mund t'i bëhet personit i cili është i inkuadruar në punë në atë vend nëse ai pajtohet që ta merr në dorëzim shkresën.

2. Nëse konstatohet se personi të cilit duhet t'i dorëzohet shkresa nuk është i pranishëm dhe personat nga paragrafi 1 i këtij neni për këtë arsye shkresën nuk mund ta dorëzojnë me kohë, do të kthehet shkresa duke shënuar ku gjendet personi që mungon.

Neni 81

Dorëzimi i mbrojtësit të autorizuar

1. Nëse i pandehuri e ka mbrojtësin, dorëzimi i vendimeve nga dorëzimi i të cilëve rrjedhë afati për ankesë, do t'i bëhet mbrojtësit, e nëse janë disa sish, dorëzimi do t'i bëhet vetëm njërit prej tyre.

2. Nëse i dëmtuari e ka përfaqësuesin ligjor ose përfaqësuesin me prokurë, dorëzimi i vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i bëhet atij, e nëse ekzistojnë disa sish atëherë do t'i dorëzohet vetëm njërit prej tyre.

Neni 82

Vërtetimi për dorëzim

1. Vërtetimin për dorëzimin e bërë (fletë dorëzimin) e nënshkruan marrësi dhe dorëzuesi. Marrësi në fletë dorëzimin e vet do ta shënojë datën e marrjes në dorëzim, data dhe muaji i marrjes në dorëzim shkruhen me fjalë.

2. Nëse marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje që të nënshkruhet, atë do ta nënshkruajë dorëzuesi dhe në vërtetimin për dorëzimin e bërë do ta shënojë vërejtjen pse e ka nënshkruar për marrësin.

3. Nëse marrësi refuzon që ta nënshkruajë fletë dorëzimin, dorëzuesi këtë gjë do ta shënojë në

fletë dorëzim dhe do ta shënojë datën e dorëzimit, me çka konsiderohet se është bërë dorëzimi.

Neni 83 **Refuzimi i pranimit**

Kur marrësi ose anëtarë i rritur i familjes së tij në rastin nga neni 80 i këtij ligji, refuzon t'i marrë në dorëzim shkresat, dorëzuesi në fletë dorëzim do ta shënojë datën, orën dhe arsyen e refuzimit të marrjes në dorëzim, kurse shkresën do ta lejë në banesën e marrësit ose në lokalin ku ai është i inkuadruar në punë dhe në këtë mënyrë është bërë dorëzimi.

Neni 84 **Rastet e veçanta të dorëzimit**

1. Personave pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të Policisë së Kosovës, punëtorëve të komunikacionit tokësorë, dhe ajror, dorëzimi i letërthirrjeve u bëhet nëpërmjet komandës së tyre, respektivisht udhëheqësit të drejtpërdrejtë, e sipas nevojës, në këtë mënyrë mund të bëhet dorëzimi edhe i shkresave të tjera.

2. Personave të privuar nga liria, dorëzimi u bëhet nëpërmjet drejtorisë së Institucionit Korrektues në të cilin janë vendosur.

3. Personave të cilët gëzojnë të drejtën e imunitetit në Republikën e Kosovës, nëse me marrëveshje ndërkombëtare nuk është paraparë ndryshe, shkresat iu dorëzohen nëpërmjet ministrisë kompetente për punë të jashtme.

4. Shtetasve të Republikës së Kosovës në shtetin tjetër, shkresat iu dërgohen nëpërmjet përfaqësive diplomatike apo konsullore të Republikës së Kosovës, me kusht që shteti tjetër nuk kundërshton mënyrën e tillë të dorëzimit dhe që personi të cilit i dorëzohet në mënyrë vullnetare pajtohet që të pranojë shkresën. Nëpunësi zyrtar apo i autorizuar i përfaqësisë diplomatike apo konsullore e nënshkruan fletë dorëzimit si dorëzues, nëse shkresa i është dërguar vetë përfaqësisë, ndërsa nëse shkresa është dërguar me postë, atë e vërteton në fletë dorëzim.

Neni 85 **Zbatimi subsidiar**

Për rastet që nuk janë paraparë me këtë ligj, dorëzimi bëhet përshtatshëm me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

KAPITULLI XVIII **FILLIMI DHE RRJEDHIMI I PROCEDURËS SË KUNDËRVAJTJES**

Neni 86 **Paraqitja e kërkesave**

1. Procedura e kundërvajtjes fillon në bazë të kërkesës së paraqitur për fillimin e procedurës së kundërvajtjes.

2. Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes mund ta paraqesin organet e autorizuara

dhe i dëmtuari.

Neni 87 **Përmbajtja e kërkesës**

1. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë:

1.1. të dhënat themelore për të pandehurin (emrin dhe mbiemrin, emrin dhe mbiemrin e njërit prind, vendlindjen dhe datëlindjen, vendbanimin dhe vendin e inkuadrimin në punë, rrugën e numrin dhe profesionin), respektivisht emrin dhe selinë e personit të pandehur juridik, kurse për personin përgjegjës në personin juridik edhe funksionin që e ushtron në atë person juridik;

1.2. përshkrimin faktik të veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes, kohën dhe vendin e kundërvajtjes së kryer dhe rrethana të tjera të nevojshme që kundërvajtja të caktohet në mënyrë më të hollësishme;

1.3. kualifikimi juridik i kundërvajtjes;

1.4. propozimi për provat që duhet të administrohen.

2. Nëse kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes nuk i përmban të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni, ajo do t'i kthehet paraqitësit që t'i evitojë të metat brenda afatit të caktuar. Në rast se paraqitësi i kërkesës nuk i eviton të metat brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa dhe kërkesa e këtillë do të hedhet poshtë me vendim.

3. Afati nga paragrafi 2 i këtij neni nuk mund të jetë më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë.

4. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes të cilën e paraqet i dëmtuari, patjetër përmban emrin dhe mbiemrin dhe adresën e banesës së të pandehurit, si dhe shumën e dëmit që është shkaktuar.

Neni 88 **Fillimi i procedurës**

Kur gjyqtari e merr në dorëzim kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, do të hetojë, a ekzistojnë kushtet e mjaftueshme që të fillojë procedura e kundërvajtjes dhe lidhur me këtë gjë do të merr vendim.

Neni 89 **Hedhja poshtë e kërkesës**

1. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes do të hedhet poshtë me vendim, nëse konstaton se nuk ekzistojnë kushtet për fillimin e procedurës së kundërvajtjes si në vijim:

1.1. kur veprimi i përshkruar në kërkesë nuk paraqet kundërvajtjen;

1.2. kur ekzistojnë bazat që e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtjen;

- 1.3. kur është shkaktuar parashkrimi për fillimin e procedurës së kundërvajtjes;
 - 1.4. kur kërkesën e ka paraqitur organi, respektivisht personi i paautorizuar;
 - 1.5. kur krijohen kushte të tjera ligjore për shkak të të cilave nuk mund të fillojë procedura.
2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i dorëzohet paraqitësit të kërkesës, kurse do të informohet i dëmtuari se kërkesën pasurore - juridike mund ta realizojë në kontestin civil.
3. Kundër vendimit sipas paragrafit 2 të këtij neni paraqitësi i kërkesës ka të drejtë ankese në afat prej tetë (8) ditësh prej ditës së dorëzimit të vendimit.
4. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes do të hedhet poshtë me vendim, nëse konstatohet se nuk ekzistojnë kushtet për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, kur:
- 4.1. veprimi i përshkruar në kërkesë nuk paraqet kundërvajtje;
 - 4.2. ekzistojnë bazat që përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje;
 - 4.3. është shkaktuar parashkrimi për fillimin e procedurës së kundërvajtjes;
 - 4.4. kërkesën e ka paraqitur organi, respektivisht personi i paautorizuar;
 - 4.5. krijohen kushte të tjera ligjore për shkak të të cilave nuk mund të fillojë procedura.
5. Vendimi nga paragrafi 4 i këtij neni do t'i dorëzohet paraqitësit të kërkesës, kurse do të informohet i dëmtuari se kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontestin civil.
6. Nëse gjyqtari nuk e hedhë poshtë kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, do të merr vendim me të cilin fillon procedura e kundërvajtjes.
7. Vendimi për fillimin e procedurës së kundërvajtjes nuk i dërgohet paraqitësit të kërkesës, e as të pandehurit.
8. Kundër vendimit nga paragrafi 7 i këtij neni nuk lejohet ankesa.

Neni 90

Ndërprerja e procedurës së kundërvajtjes

1. Gjyqtari, i cili e zhvillon procedurën e kundërvajtjes me vendim do ta ndërprerë procedurën:
 - 1.1. nëse nuk dihet vendqëndrimi i të pandehurit ose ndodhet në arrati apo për ndryshe nuk është i arritshëm për organet shtetërore ose ndodhet në botën e jashtme në kohën e caktuar;
 - 1.2. nëse te i pandehuri është shkaktuar sëmundja e përkohshme psikike ose çrregullimi i përkohshëm psikik.

2. Para se të ndërpritet procedura do të mblidhen të gjitha provat për kundërvajtjen dhe përgjegjësinë e të pandehurit, të cilat mund të sigurohen.
3. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur të pushojnë pengesat që e kanë shkaktuar atë.
4. Për ndërprerjen dhe vazhdimin e procedurës do të informohet paraqitësi i kërkesës si dhe pala e dëmtuar.

Neni 91

Masat për sigurimin e prezencës së të pandehurit

1. Masat që mund të ndërmerren ndaj të pandehurit për sigurimin e prezencës së tij dhe për zhvillimin e suksesshëm të procedurës së kundërvajtjes janë:

- 1.1. thirrja;
- 1.2. sjellja;
- 1.3. dorëzania, dhe;
- 1.4. ndalja.

Neni 92

Thirrja e të pandehurit

1. Prezenca e të pandehurit në procedurën e kundërvajtjes sigurohet me thirrjen e tij.
2. Thirrja bëhet me dërgimin e letërthirrjes nga gjykata që përmban:
 - 2.1. emrin e gjykatës;
 - 2.2. emrin dhe mbiemrin e të pandehurit;
 - 2.3. emërtimin e kundërvajtjes e cila i vihet në barrë;
 - 2.4. datën dhe orën, si dhe vendin ku duhet të vijë i pandehuri;
 - 2.5. shënimin se thirret në cilësinë e të pandehurit, dhe;
 - 2.6. vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit.
3. Në letërthirrjen me të cilën thirret do të shënohet se a duhet patjetër personalisht të vijë që të merret në pyetje ose mbrojtjen e vet mund ta japë me shkrim.
4. Kur i pandehuri thirret që të vijë personalisht sepse është e domosdoshme marrja e tij në pyetje, në letërthirrje do të paralajmërohet se në rast të mos përgjegjës do të sillet me dhunë.

5. Nëse për konstatimin e përgjegjësisë në procedurën e kundërvajtjes nuk është e domosdoshme prezenca e të pandehurit, në letërthirrje do të paralajmërohet se për kundërvajtjen në rast të mos përgjegjës në thirrje do të merret vendimi pa marrjen e tij në pyetje.

6. Dispozitat e këtij neni përshtatshëmrisht do të aplikohen edhe ndaj përfaqësuesit të personit juridik.

Neni 93

Thirrja e dëshmitarëve

1. Si dëshmitarë thirren personat për të cilët besohet se mund të japin informata për kundërvajtjen, për të pandehurin dhe për rrethanat e tjera të rëndësishme.

2. I dënuari mund të merret në pyetje si dëshmitar.

3. Secili person i cili thirret në cilësinë si dëshmitar është i obliguar që t'i përgjigjet letërthirrjes, e nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe është i obliguar edhe të dëshmojë.

4. Thirrja e dëshmitarit bëhet me dërgimin e letërthirrjes me shkrim në të cilën do të shënohet, emri, mbiemri dhe profesioni i dëshmitarit, koha dhe vendi i ardhjes, kundërvajtja dhe lënda në të cilën thirret, shënimi se thirret si dëshmitar dhe paralajmërimi për pasojat e mungesës së paarsyeshme.

5. Dëshmitari i cili për shkak të moshës së shtyrë, sëmundjes ose të të metave të rënda trupore nuk mund t'i përgjigjet letërthirrjes, mund të merret në pyetje në banesën e vet ose atje ku gjendet.

6. Kur i dëmtuari thirret si dëshmitar në letërthirrje do të shënohet kjo gjë.

7. Nëse thirrja është bërë me gojë do të shënohet kjo gjë në shkresa.

Neni 94

Sjellja

1. Kur personi i thirrur në mënyrë të rregullt nuk i përgjigjet letërthirrjes dhe nuk e arsyeton mungesën e vet, do të urdhërohet sjellja e tij, nëse prezenca e tij është e domosdoshme.

2. Sjellja e të pandehurit mund të urdhërohet vetëm nëse në letërthirrje ka qenë e shënuar se do të silllet me dhunë nëse nuk i përgjigjet letërthirrjes.

3. Sjellja e të pandehurit mund të urdhërohet pa letërthirrjen paraprake nëse është gjetur në kryerjen e kundërvajtjes e nuk mund ta argumentojë identitetin e vet ose nuk e ka vendbanimin, ose me shkuarjen e tij në botën e jashtme mund t'i shmanget përgjegjësisë për kundërvajtje apo që të parandalohet kryerja e mëtejshme e kundërvajtjes.

4. Nëse përfaqësuesi i thirrur në mënyrë të rregullt i personit juridik të pandehur nuk i përgjigjet letërthirrjes, e nuk e arsyeton mungesën e vet, do të urdhërohet sjellja e tij.

5. Sjellja e të dëmtuarit mund të urdhërohet vetëm nëse është thirrur si dëshmitar.

6. Personat nga paragrafi 3 i këtij neni mund të sillen nga ana e personave zyrtarë të policisë edhe pa urdhëresën e gjyqtarit.

7. Kundër personave ushtarakë, zyrtarëve policor ose zyrtarëve korrektues nuk do të jepet urdhëresa për sjellje por do të kërkohet prej komandës së tyre, respektivisht institucionit të tyre që t'i sjellë.

8. Shpenzimet e sjelljes i paguan personi i cili sillet.

Neni 95

Përmbajtja e urdhëresës për sjellje

1. Urdhëresa për sjellje jepet me shkrim.

2. Urdhëresa përmban emrin dhe mbiemrin e personit i cili duhet të sillet, arsyen për shkak të së cilës urdhërohet sjellja, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit i cili urdhëron sjelljen.

3. Urdhëresën për sjellje e zbaton organi i policisë.

4. Personi të cilit i është besuar zbatimi i urdhëresës ia dorëzon urdhëresën personit të cilit i referohet dhe e thërret që të shkojë me të. Nëse personi të cilit i referohet urdhëresa nuk vepron sipas urdhëresës, organi i policisë do ta sjellë.

Neni 96

Dorëzania

1. Nëse ka filluar procedura e kundërvajtjes kundër të pandehurit i cili nuk e ka vendbanimin e përhershëm në Republikën e Kosovës ose i cili qëndron përkohësisht në botën e jashtme, si dhe në raste të tjera kur ekziston rreziku se me anë të arratisë mund të shmanget nga përgjegjësia për kundërvajtje, mund të kërkohet që ta japë dorëzaninë.

2. Dorëzania nuk mund të caktohet para se të merret në pyetje i pandehuri edhe pa pëlqimin e tij.

Neni 97

Përmbajtja dhe lartësia e dorëzanisë

1. Dorëzania deponohet me para. Lartësinë e dorëzanisë e cakton gjyqtari i kundërvajtjes, duke marrë parasysh peshën e kundërvajtjes, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjen pasurore të personit i cili e jep dorëzaninë.

2. Përgjithësisht paragrafit 1 të këtij neni, dorëzania konsiston në dhënien e parave në dorë, letrave me vlerë, sendeve të çmueshme ose sendeve të luajtshme me vlerë të madhe të cilat mund të shndërrohen lehtë në para dhe të ruhen lehtë, personi i cili e jep dorëzaninë ose ka obligimin personal me një ose me disa qytetarë se në rast të arratisjes së të pandehurit do ta paguajë shumën e përcaktuar të dorëzanisë.

Neni 98

Veprimi me dorëzanimë

1. Dorëzania ndalet, sipas rregullit, derisa të merret vendimi i formës së prerë për kundërvajtjen.
2. Nëse është marrë vendimi i formës së prerë mbi pezullimin e procedurës së kundërvajtjes do të kthehet dorëzania e dhënë.
3. Nëse i ndëshkuari nuk e paguan dëmin ose nuk i paguan shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes, shuma e përcaktuar do të arkëtohet nga dorëzania e dhënë, e nëse shuma e dhënë nuk është e mjaftueshme, prej saj në radhë të parë do të kompensohet shuma e dëmit.
4. Nëse i ndëshkuari nuk e paguan gjobën, respektivisht shumën e përcaktuar të përfitimit të marrë pasuror, pas arkëtimit të dëmit dhe të shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes, do të arkëtohet gjoba dhe shuma e përcaktuar të përfitimit pasuror.
5. Nëse i pandehuri ikë apo e braktisë territorin e Republikës së Kosovës, gjykata me vendim do të caktoj që vlera e dhënë si dorëzani të paguhet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI XIX

MARRJA NË PYETJE E TË PANDEHURIT

Neni 99

Mënyra e marrjes në pyetje të të pandehurit

1. I pandehuri, sipas rregullit, merret në pyetje me gojë.
2. Gjatë marrjes në pyetje i pandehuri duhet të tregojë emrin dhe mbiemrin, nofkën nëse ka; emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij; vendlindjen dhe vendbanimin e tij; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; numrin e tij personal të identifikimit; kombësinë dhe shtetësinë; profesionin dhe rrethanat familjare; shkollimin; a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij materiale; dhe nëse është i mitur, identitetin e përfaqësuesit të tij ligjor.
3. Pas marrjes së të dhënave personale, të pandehurit do t'i komunikohet pse është i pandehur dhe do të ftohet që të tregojë çdo gjë që di në mbrojtjen e vet.
4. Nëse i pandehuri nuk do të përgjigjet, ose nuk do të përgjigjet në pyetjet e bëra, do të paralajmërohet se kështu mund të vështirësojë mbledhjen e provave për mbrojtjen e vet. Me rastin e marrjes në pyetje të pandehurit do t'i bëhet e mundur që në shprehjen e papenguar të deklarohet për të gjitha rrethanat që e ngarkojnë dhe t'i tregojë të gjitha faktet që i shërbejnë për mbrojtjen e tij.
5. Kur i pandehuri e përfundon thënien e vet, do t'i bëhet pyetja, po që se është e nevojshme që të plotësohen zbrazëtitë ose të evitohen kundërthëniet dhe paqartësitë në thënien e tij.
6. Dispozitat për marrjen në pyetje të të pandehurit përshtatshëmrisht do të zbatohen edhe për marrjen në pyetje të personit përgjegjës në personin juridik, të përfaqësuesit të pandehurit të personit juridik dhe të ndërmarrësve.

Neni 100

Respektimi i personalitetit të të pandehurit

1. Marrja në pyetje e të pandehurit bëhet duke respektuar personalitetin e tij.
2. Ndaj të pandehurit nuk guxon të përdoret forca, kanosja, mashtrimi dhe mjete të ngjashme në mënyrë që të sigurohet deklarata ose pranimi i tij.

Neni 101

Mbrojtja me shkrim, ballafaqimi dhe marrja në pyetje nëpërmjet interpretit

1. Nëse gjykata e sheh se nuk është e nevojshme marrja e drejtpërdrejtë në pyetje me gojë duke marrë parasysh rëndësinë e kundërvajtjes dhe të dhënat që i disponon, do ta thërret të pandehurin që mbrojtjen e vet ta japë me shkrim. Në rastin e tillë i pandehuri mund të kërkojë që të merret në pyetje edhe me gojë.
2. I pandehuri mund të ballafaqohet me dëshmitarin ose me të pandehurin tjetër nëse thëniet e tyre nuk përputhen në pikëpamje të fakteve të rëndësishme. Të ballafaquarit do të merren në pyetje për çdo rrethanë për të cilën nuk përputhen thëniet dhe përgjigjet e tyre të shënohen në procesverbal.
3. Nëse i pandehuri është i shurdhër do t'i bëhet pyetja me shkrim, e nëse është memec do të thirret që të përgjigjet me shkrim. Nëse marrja në pyetje nuk mund të bëhet në këtë mënyrë, do të thirret për interpret personi i cili mund të merret vesh me të pandehurin.

KAPITULLI XX

PYETJA E DËSHMITARIT

Neni 102

Cilësia e dëshmitarit dhe detyrimi i dëshmimit

1. Dëshmitarët pyeten nëse kjo është e nevojshme për konstatimin e fakteve.
2. I dëmtuari mund të pyetet si dëshmitar.
3. Secili person i thirrur është i obliguar që t'i përgjigjet letërthirrjes, dhe nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, është i detyruar edhe të dëshmojë. Personat të cilët për shkak të sëmundjes ose të paaftësisë nuk mund t'i përgjigjen letërthirrjes, do të merren në pyetje në banesën e tyre.
4. Dëshmitari nuk është i obliguar të përgjigjet në disa pyetje, nëse me siguri besohet se me këtë do t'i shkaktonte vetvetes ose të afërmit të vet turp të madh, dëm të konsiderueshëm material ose ndjekjen penale.
5. Vendimi nuk mund të bazohet në thëniet e dëshmitarit nëse:
 - 5.1. si dëshmitar është pyet personi i cili nuk mund të pyetet si dëshmitar sipas nenit 104 të këtij ligji;

5.2. si dëshmitar është pyet personi i cili është i liruar nga detyra e dëshmimit;

5.3. dëshmitari nga nën-paragrafi 5.2 i këtij paragrafi ndërsa nuk është paralajmëruar për atë apo shprehimisht nuk ka heq dorë nga ajo e drejtë ose heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal;

5.4. thënia e dëshmitarit është marr me forcë, nën kërcënim apo me anë të mjetit tjetër të ndaluar.

Neni 103

Ndalimi i dëshmimit

1. Nuk mund të merret në pyetje si dëshmitar:

1.1. personi i cili me thënien e vet do ta shkelte detyrën e ruajtjes së sekretit zyrtar ose ushtarak, derisa organi kompetent mos ta liroj nga ajo detyrë;

1.2. mbrojtësi i të pandehurit lidhur me atë që ia ka besuar i pandehuri si mbrojtësit të vet, përveç nëse vetë i pandehuri e kërkon këtë gjë.

2. Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni merret në pyetje pa lejen paraprake, në thënien e tij nuk mund të mbështetet vendimi për kundërvajtjen.

Neni 104

Lirimi nga detyra e dëshmimit

1. Janë të liruar nga detyra e dëshmimit:

1.1. bashkëshorti i të pandehurit;

1.2. personat me gjini të gjakut të të pandehurit në vijën e drejtë pa kufi, personat në gjini të gjakut në vijën anësore deri në shkallën e katërt, si dhe personat e gjinisë së krushqisë deri në shkallën e dytë;

1.3. i adoptuari ose adoptuesi i të pandehurit;

1.4. predikuesi fetar lidhur me atë që i ka rrëfyer i pandehuri.

2. Gjyqtari i cili zhvillon procedurën është i obliguar që personat nga paragrafi 1 i këtij neni t'i paralajmërojë se nuk janë të obliguar të dëshmojnë. Paralajmërimi dhe përgjigja shënohen në procesverbal.

3. Nëse gjyqtari nuk vepron në vështrim të paragrafit 2 të këtij neni dhe personi nga paragrafi 1 i këtij neni merret në pyetje si dëshmitar, në thënien e tij nuk mund të mbështetet vendimi për kundërvajtjen.

4. Personi i cili ka bazë që të mos dëshmojë ndaj njërit prej të pandehurve është i liruar nga detyra e dëshmimit edhe ndaj të pandehurve të tjerë, nëse thënia e tij sipas natyrës së çështjes

nuk mund të kufizohet vetëm ndaj të pandehurve të tjerë.

Neni 105

Mënyra e pyetjes së dëshmitarëve

1. Dëshmitarët pyeten veç e veç dhe pa prezencën e dëshmitarëve të tjerë.
2. Dëshmitari është i obliguar që përgjigjet t'i japë me gojë.
3. Dëshmitarit më parë do t'i tërhiqet vërejtja se është i obliguar që të flet të vërtetën, se asgjë nuk guxon ta heshtë dhe do të paralajmërohet për pasojat e dëshmisë së rrejshme, kurse dëshmitari do të paralajmërohet se nuk është i obliguar që t'u përgjigjet pyetjeve nga neni 102, paragrafi 4 i këtij ligji.
4. Dëshmitari pastaj do të pyetet për emrin dhe mbiemrin, emrin e prindërve, moshën, vendlindjen, profesionin, vendbanimin dhe raportin e tij me të pandehurin dhe me të dëmtuarin.
5. Pasi t'i bëhen pyetjet e përgjithshme, dëshmitari ftohet që të flet për krejt atë që e di lidhur me çështjen, pastaj do t'i bëhen pyetjet për verifikim, plotësim dhe sqarim.
6. Nuk lejohet që të bëhen pyetjet e atilla në të cilat tashmë është e përmbajtur se si duhet përgjigjur.
7. Dëshmitari gjithmonë do të pyetet se si është e njohur ajo gjë për të cilën dëshmon.
8. Nëse dëshmitari është i shurdhër, pyetja do t'i bëhet me shkrim, e nëse është memec do të ftohet që të përgjigjet me shkrim. Nëse pyetja nuk mund të bëhet në këtë mënyrë si interpret do të ftohet personi i cili mund të merret vesh me dëshmitarin.

Neni 106

Ballafaqimi i dëshmitarëve

1. Dëshmitarët mund të ballafaqohen nëse thëniet e tyre nuk përputhen në pikëpamje të fakteve të rëndësishme. Të ballafaquarit për secilën rrethanë për shkak të së cilës nuk përputhen midis tyre, do të merren në pyetje veç e veç dhe përgjigja e tyre do të shënohet në procesverbal.
2. Në të njëjtën kohë mund të ballafaqohen vetëm dy dëshmitarë.
3. Nëse është e nevojshme që të konstatohet se dëshmitari a e njeh personin ose sendet, do të kërkohet prej tij që më parë t'i përshkruajë dhe t'i tregojë shenjat sipas të cilave dallohen e pastaj do t'i prezantohen me qëllim të rinjohjes, së bashku me personat e tjerë të panjohur për te, respektivisht nëse është e mundur kjo gjë, bashkë me sendet e llojit të njëjtë.

Neni 107

Mosardhja dhe refuzimi për të dëshmuar

1. Nëse dëshmitari, i cili është thirrur në mënyrë të rregullt nuk vjen, kurse nuk e arsyeton mungesën ose pa leje apo shkak të arsyeshëm largohet prej vendit ku duhet të pyetet, mund të ndëshkohet me gjobë deri në njëzetë (20) euro.

2. Nëse vjen dëshmitari, e pasi është paralajmëruar për pasojat, refuzon të dëshmojë pa arsye ligjore, mund të ndëshkohet me gjobë deri në tridhjetë (30) euro, e nëse edhe pastaj refuzon që të dëshmojë mund të ndëshkohet me gjobë deri në gjashtëdhjetë (60) euro.
3. Vendimi mbi ndëshkimin shënohet në procesverbal.
4. Ankesa kundër vendimit mbi gjobën nuk e ndal ekzekutimin e vendimit.
5. Nëse dëshmitari pajtohet që të dëshmojë menjëherë pasi i është dhënë dënimi, vendimi i marrë do të shfuqizohet.

KAPITULLI XXI KËQYRJA E VENDIT DHE EKSPERTIMI

Neni 108 Këqyrja e vendit

1. Këqyrja e vendit ndërmerret kur për konstatimin ose për sqarimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në procedurën e kundërvajtjes është i nevojshëm vrojtimi i drejtpërdrejtë.
2. Gjyqtari i cili zhvillon procedurën e kundërvajtjes përcakton se cilët persona do të thirren që të marrin pjesë në këqyrjen e vendit. Për këqyrjen në vend mbahet procesverbal, në të cilën shënohet emri i gjykatës i cili kryen këqyrjen në vend, personat të cilët marrin pjesë, rezultatet e këqyrjes në vend dhe faktet e tjera të rëndësishme.
3. Këqyrja e vendit mund të bëhet edhe me pjesëmarrjen e ekspertit.

Neni 109 Ekspertimi

1. Ekspertimi caktohet me propozimin e palëve kur për konstatimin ose për vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm duhet të sigurohet konstatimi dhe mendimi nga personi i cili ka njohuri të nevojshme profesionale. Gjykata sipas detyrës zyrtare mund të caktoj ekspertimin, nën kushtet e përcaktuara me ligj.
2. Ekspertimi mund t'i besohet institucionit përkatës profesional, organit publik ose ekspertit, në rend të parë nga lista e ekspertëve të përhershëm gjyqësor, ndërsa organet e tjera ose personat mund të caktohen vetëm nëse ekziston rreziku nga shtyrja, nëse ekspertët e përhershëm janë të penguar ose nëse këtë e kërkojnë rrethanat e tjera. Sipas rregullit caktohet një ekspert, ndërsa dy apo më shumë ekspert nëse ekspertiza është e ndërlikuar.
3. Ekspertimi caktohet me urdhëresën me shkrim të gjyqtarit, i cili e zhvillon procedurën. Në urdhëresë do të shënohet lidhur me cilat fakte duhet të bëhet ekspertimi dhe kujt i besohet.

Neni 110 Dënimi i ekspertit

1. Personi i cili ftohet si ekspert është i obliguar që t'i përgjigjet letërthirrjes dhe ta japë konstatimin

dhe mendimin e vet.

2. Nëse eksperti i cili është ftuar në mënyrë të rregullt nuk vjen, nuk e arsyeton mungesën dhe nëse refuzon të bëjë ekspertimin mund t'i urdhërohet që t'i kompensojë shpenzimet e shkaktuara, e mund edhe të ndëshkohet me gjobë deri në pesëdhjetë (50) euro.

3. Vendimi për dënim shënohet në procesverbal. Ankesa kundër vendimit për dënim të ekspertit nuk e shtynë ekzekutimin e dënimit.

Neni 111

Personat të cilët nuk mundën me qenë ekspert dhe përjashtimi

1. Për ekspert nuk mund të angazhohet personi i cili nuk mund të pyetet si dëshmitar ose personi i cili është liruar nga obligimi që të dëshmojë, si dhe personi ndaj të cilit është bërë kundërvajtja, e nëse personi i tillë është marrë për ekspert, në konstatimin dhe mendimin e tij nuk mund të mbështetet vendimi për kundërvajtjen.

2. Për ekspert nuk mund të merret personi i cili është marrë në pyetje si dëshmitar.

3. Të pandehurit dhe të dëmtuarit do t'u komunikohet emri i ekspertit, sipas rregullit para se të ndërmerret ekspertimi.

4. I pandehuri, paraqitësi i kërkesës dhe i dëmtuari mund të kërkojnë përjashtimin e ekspertit.

5. Lidhur me kërkesën për përjashtimin e ekspertit vendos gjyqtari, i cili e zhvillon procedurën.

6. Ankesa kundër vendimit me të cilin refuzohet kërkesa për përjashtimin e ekspertit e shtynë bërjen e ekspertimit, po që se nuk ekziston rreziku për shkak të shtyrjes.

Neni 112

Rrjedha e ekspertimit

1. Para fillimit të ekspertimit do të ftohet eksperti që objektin e ekspertimit ta shqyrtojë me kujdes, që në mënyrë të saktë të theksojë të gjitha ato që i vëren dhe i gjen, dhe mendimin e vet ta paraqes në mënyrë të paanshme dhe në pajtim me rregullat shkencore ose me shkathhtësitë. Ai do të paralajmërohet posaçërisht për pasojat e dhënies së dëshmisë së rrejshme.

2. Ekspertimin e udhëheq gjyqtari i cili e zhvillon procedurën.

3. Ekspertit mund t'i jepen sqarimet, e mund t'i lejohet edhe shqyrtimi i shkresave. Me kërkesën e ekspertit mund të administrohen prova të reja në mënyrë që të konstatohen rrethanat e rëndësishme për ekspertim.

4. Eksperti i shikon objektet e ekspertimit në prezencën e gjyqtarit i cili e zhvillon procedurën dhe të procesmbajtësit, përveç nëse për ekspertim janë të nevojshme hetimet e gjata ose nëse hetimet bëhen në institucionet, respektivisht në organin shtetëror ose nëse një gjë të tillë e kërkojnë arsyet e moralit.

Neni 113**Konstatimi dhe mendimi i ekspertit**

1. Konstatimi dhe mendimi i ekspertit, sipas rregullit, menjëherë shënohen në procesverbal. Përgjatimisht, ekspertit mund t'i lejohet që më vonë ta paraqes mendimin me shkrim brenda afatit të cilin e cakton gjyqtari.
2. Konstatimi dhe mendimi i ekspertit iu dërgohet palëve në procedurë për të cilin mund të deklarohen në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
3. Dispozitat e këtij ligji që vlejné për ekspertët përshtatshëmrisht zbatohen edhe për interpretët.

KAPITULLI XXII**URDHËR KONTROLLI I LOKALEVE DHE I PERSONAVE****Neni 114****Procedura para fillimit të kontrollit**

Urdhër kontrolli caktohet me urdhëresë me shkrim të gjyqtarit, i cili e zhvillon procedurën e kundërvajtjes. Zbatimin e kontrollit e bën Policia e Kosovës, përveç nëse me urdhëresë për kontroll përcaktohet ndryshe.

Neni 115**Mënyra dhe veprimet gjatë zbatimit të urdhër kontrollit**

Të gjitha veprimet nga zyrtari që zbaton urdhër kontrollin e që përshin: kufizimet në ekzekutimin e urdhër kontrollit, procedurën para fillimit të kontrollit dhe kufizimet në kontroll, bëhen në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Neni 116**Marrja e përkohshme e sendeve**

1. Sendet që janë përdorur për kryerjen e kundërvajtjes ose janë destinuar për atë qëllim, të vënë në dorë ose të krijuara me kundërvajtjen e kryer, si dhe sendet që mund të shërbejnë si provë në procedurën e kundërvajtjes, do të merren përkohësisht edhe para se të merret vendimi për kundërvajtjen.
2. Marrjen e përkohshme të sendeve e cakton me urdhëresë me shkrim gjyqtari. Kopja e urdhëresës patjetër duhet t'i dorëzohet personit nga i cili merren sendet.
3. Me ligj mund të autorizohen edhe personat zyrtarë të organeve inspeksionale, zyrtarë doganor të shërbimit doganor dhe zyrtarët e autorizuar policor që përkohësisht të merren sendet nga paragrafi 1 i këtij neni kur në kryerjen e detyrës zyrtare mësojnë për kundërvajtjen. Këto organe janë të obliguara që gjykatën ta informojnë për marrjen e përkohshme të sendeve dhe të kujdesen për ruajtjen e tyre, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.
4. Personit prej të cilit janë marrë sendet, i jepet vërtetimi me shënimin e saktë të sendeve të marra.

5. Nëse sendi priset lehtë ose nëse ruajtja e tij kërkon shpenzime të mëdha, gjyqtari do të caktojë që të shitet sendi, ndërsa mjetet e fituara nga shitja të dorëzohen në ruajtje në bankë.

6. Sendet e marra përkohësisht ose të hollat e fituara me shitjen e sendeve i kthehen pronarit nëse procedura e kundërvajtjes nuk përfundon me vendim me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës, përveç kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme apo arsyet e moralit, për çka gjykata nxjerr vendim të posaçëm.

7. Nëse brenda afatit prej një viti nuk paraqitet askush për sendin ose për të hollat e fituara nga shitja e sendeve, do të merret vendimi se sendi bëhet pronë publike, respektivisht se të hollat deponohen në buxhetin e Kosovës. Pronari i sendeve ka të drejtë që në kontestin civil të kërkojë kthimin e sendeve ose të hollave të fituara nga shitja e sendeve. Parashkrimi i kësaj të drejte fillon nga data e publikimit të shpalljes.

Neni 117

Veprimi me sendin e huaj të gjetur te i pandehuri

1. Kur te i pandehuri gjendet sendi i huaj, e nuk dihet i kujt është, gjyqtari i cili e zhvillon procedurën e kundërvajtjes do ta përshkruajë atë send dhe përshkrimin do ta shpall në tabelën e shpalljeve të kuvendit të komunës në territorin e të cilit është kryer kundërvajtja.

2. Në shpallje do të ftohet pronari që të paraqitet brenda afatit prej një viti nga data e publikimit të shpalljes dhe do të paralajmërohet që pas kalimit të atij afati sendi do të shitet. Të hollat e fituara nga shitja e sendeve janë të hyrat e komunës në territorin e së cilës është marrë sendi.

3. Nëse fjala është për sendet me vlerë më të madhe publikimi mund të bëhet me anë të gazetave të ditës.

4. Nëse sendi priset lehtë ose ruajtja e tij ka të bëjë me shpenzime të konsiderueshme, atëherë do të shitet sipas dispozitave që vlejnë për procedurën e përmbarimit, kurse të hollat do t'i dorëzohen për ruajtje bankës.

5. Sipas dispozitës së paragrafit 3 të këtij neni do të vepohet edhe kur sendi i takon kryesit të arratisur ose të panjohur të kundërvajtjes.

Neni 118

Shkelja e rendit në procedurën e kundërvajtjes

1. Personi i cili pranë gjykatës që e zhvillon procedurën e kundërvajtjes edhe pse i është tërhequr vërejtja, ka sjellje të pa hijshme, ose në ndonjë mënyrë tjetër e pengon punën e gjykatës, do të ndëshkohet me gjobë prej pesëdhjetë (50) euro.

2. Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni ndalë ekzekutimin e vendimit.

KAPITULLI XXIII SHQYRTIMI GJYQËSOR

Neni 119

Caktimi i shqyrtimit gjyqësor

1. Gjyqtari i cili zhvillon procedurën e shkallës së parë, do ta caktoj shqyrtimin gjyqësor kur një gjë e tillë është e nevojshme për sqarimin më të mirë të çështjes.
2. Në shqyrtimin gjyqësor thirren i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, e sipas nevojës edhe paraqitësi i kërkesës, dëshmitarët dhe ekspertët. Nëse i pandehuri është person juridik, në shqyrtim thirret përfaqësuesi i personit juridik.
3. Për datën, orën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit informohet edhe i dëmtuari.

Neni 120

Mosardhja e të pandehurit

1. Gjyqtari i cili zhvillon procedurën mund të vendos që shqyrtimi të mbahet në mungesën e të pandehurit i cili është thirr në mënyrë të rregullt, nëse ai më parë është marrë në pyetje, kurse gjyqtari konstaton se prezenca e tij nuk është e domosdoshme për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike. Në kushtet e njëjta shqyrtimi gjyqësor mund të mbahet edhe në mungesën e mbrojtësit i cili është thirr në mënyrë të rregullt, respektivisht të përfaqësuesit të personit të pandehur juridik.
2. Shqyrtimi gjyqësor do të mbahet edhe nëse nuk vjen mbrojtësi i të pandehurit i cili është thirr në mënyrë të rregullt.

Neni 121

Publiciteti i shqyrtimit publik dhe përjashtimi i publikut

1. Shqyrtimi gjyqësor është publik.
2. Gjyqtari i cili zhvillon procedurën mund të vendosë që nga shqyrtimi ose nga një pjesë e saj të përjashtohet publiku, nëse këtë gjë e kërkojnë interesat e përgjithshme ose arsyet e moralit.
3. Nëse procedura zhvillohet vetëm kundër të miturit, shqyrtimi gjyqësor gjithmonë do të mbahet pa prezencën e publikut.

Neni 122

Rrjedha e shqyrtimit

1. Shqyrtimi gjyqësor fillon me komunikimin e përmbajtjes kryesore të kërkesës, e pastaj fillon marrja në pyetje e të pandehurit. Nëse të pandehurit janë persona juridik dhe persona përgjegjës në personin juridik, më parë merret në pyetje përfaqësuesi i personit juridik e pastaj personi përgjegjës. Pas marrjes në pyetje të të pandehurit kalohet në administrimin e provave dhe me administrimin e provave të tjera.
2. Për punën në shqyrtimin gjyqësor mbahet procesverbal në të cilin shënohet në esencë

rrjedha e tërë seancës. Procesverbalin mbi shqyrtimin gjyqësor e nënshkruajnë gjyqtari dhe procesmbajtësi.

Neni 123

Të drejtat e palëve në shqyrtim

1. Paraqitësi i kërkesës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, përfaqësuesi i personit juridik, personi përgjegjës i personit juridik dhe i dëmtuari kanë të drejtë që gjatë shqyrtimit të propozojnë provat dhe të bëjnë propozime të tjera, e me lejen e gjyqtarit i cili zhvillon procedurën mund t'u bëjnë pyetje edhe personave që merren në pyetje.

2. Në shqyrtimin gjyqësor fjala e fundit gjithmonë i takon të pandehurit, respektivisht përfaqësuesit të personit të pandehur juridik ose personit përgjegjës të pandehur.

KAPITULLI XXIV

AKTGJYKIMI MBI KUNDËRVAJTJET

Neni 124

Nxjerrja e aktgjykimit

1. Procedura e kundërvajtjes përfundon me marrjen e aktgjykimit dënues ose lirues, të aktvendimit me të cilin pezullohet procedura ose të aktvendimit me të cilin kryesit të mitur të kundërvajtjes i shqiptohet masa edukuese.

2. Aktgjykimi ose aktvendimi për kundërvajtjen, mbështetet në provat dhe faktet e administruara që janë konstatuar në procedurë.

3. Aktgjykimi ose aktvendimi për kundërvajtjen, nxjerrët menjëherë pas përfundimit të të gjitha veprimeve në procedurën e kundërvajtjes, të cilat i paraprijnë nxjerrjes së aktgjykimit apo të aktvendimit.

4. Aktgjykimi për kundërvajtjen me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës për kundërvajtjen do të merret kur në procedurën e kundërvajtjes, në bazë të kërkesës së paraqitur, konstatohet ekzistimi i kundërvajtjes dhe përgjegjësia e të pandehurit.

Neni 125

Aktgjykimi për më shumë kundërvajtje

Nëse procedura e kundërvajtjes zhvillohet për disa kundërvajtje, në aktgjykim do të shënohet se për cilat kundërvajtje pezullohet procedura, e për cilat i pandehuri shpallet përgjegjës dhe ndëshkohet.

Neni 126

Aktvendimi për përfundimin e procedurës së kundërvajtjes

1. Procedura e kundërvajtjes do të përfundoj me aktvendim kur konstatohet se:

- 1.1. fjala është për veprimin që nuk është përcaktuar si kundërvajtje;
- 1.2. ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtjen;
- 1.3. procedura është zhvilluar pa kërkesën e personit, përkatësisht organit të autorizuar;
- 1.4. i pandehuri për shkak të kundërvajtjes së njëjtë është ndëshkuar me formën e prerë në procedurën e kundërvajtjes ose procedura e kundërvajtjes është përfunduar me formë të prerë, po jo për shkak të inkompetencës;
- 1.5. i pandehuri në procedurën penale është shpallur fajtor me formë të prerë për veprën e njëjtë që i përfshin edhe tiparet e kundërvajtjes;
- 1.6. i pandehuri e gëzon imunitetin diplomatik;
- 1.7. është shkaktuar parashkrimi për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes;
- 1.8. nuk ka prova që i pandehuri e ka bërë kundërvajtjen;
- 1.9. i pandehuri ka vdekur gjatë procedurës së kundërvajtjes, respektivisht ka pushuar të ekzistojë personi i pandehur juridik;
- 1.10. paraqitësi ka hequr dorë nga kërkesa para se të merr formën e prerë aktgjykimi mbi kundërvajtjen.

2. Procedura e kundërvajtjes do të përfundohet edhe në raste të tjera të caktuara me ligj.

Neni 127

Aktgjykimi me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës

1. Aktgjykimi me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës për kundërvajtje nxirret kur në procedurën e kundërvajtjes konstatohet ekzistimi i kundërvajtjes dhe i përgjegjësisë së të pandehurit për atë kundërvajtje.
2. Në aktgjykimin me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës në dispozitiv gjykata do të theksojë:
 - 2.1. cilën kundërvajtje shpallet përgjegjës, duke shënuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë tipare të kundërvajtjes dhe nga të cilat varet aplikimi i dispozitës së caktuar për kundërvajtje;
 - 2.2. emërtimi i kundërvajtjes dhe cilat dispozita për kundërvajtje janë aplikuar;
 - 2.3. për cilin dënim dënohet i pandehuri;
 - 2.4. vendimin për masat mbrojtëse dhe të konfiskimit të dobisë pasurore;
 - 2.5. vendimin për llogaritjen e privimit nga liria dhe ndaljes;

2.6. vendimin për shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes dhe për kërkesën pasurore juridike.

3. Nëse i pandehuri është dënuar me dënim me gjobë, në dispozitiv të aktgjykimit do të shënohet afati i pagesës së gjobës dhe mënyra e zëvendësimit të gjobës.

4. Nëse është shqiptuar masa mbrojtëse e konfiskimit të sendit, në dispozitiv të aktgjykimit do të caktohet si do të veprohet me sendet e konfiskuara.

Neni 128

Aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga përgjegjësia

1. Aktgjykimi, me të cilin i pandehuri lirohet nga përgjegjësia gjykata do ta shqiptojë, nëse:

1.1. vepra për të cilën ngarkohet sipas dispozitës nuk është kundërvajtje;

1.2. nuk është provuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen për të cilën kundër tij është paraqitë kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes;

1.3. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë e kundërvajtjes të pandehurit.

Neni 129

Komunikimi, përpilimi dhe dërgimi i aktgjykimit për kundërvajtjen

1. Aktgjykimi për kundërvajtjen komunikohet verbalisht nëse është i pranishëm i pandehuri.

2. Aktgjykimi për kundërvajtjen do të përpilohet me shkrim brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga dita e përfundimit të të gjitha veprimeve në procedurën e kundërvajtjes.

Neni 130

Përmbajtja e aktgjykimit për kundërvajtjen

1. Aktgjykimi për kundërvajtjen i përpiluar me shkrim përmban:

1.1. hyrjen;

1.2. dispozitivin;

1.3. arsyetimin;

1.4. udhëzimin mbi këshillën juridike, si dhe;

1.5. numrin, datën, nënshkrimin e gjyqtarit dhe vulën zyrtare.

2. Hyrja e aktgjykimit përmban:

- 2.1. emrin e gjykatës;
- 2.2. emrin, mbiemrin, vendqëndrimin dhe vendin e inkuadrimin në punë të të pandehurit, respektivisht emrin dhe selinë e personit të pandehur juridik;
- 2.3. kundërvajtjen që është objekt i procedurës;
- 2.4. bazën ligjore sipas së cilës është marrë aktgjykimi, dhe;
- 2.5. datën e marrjes së aktgjykimit.

3. Dispozitivi i aktgjykimit përmban të dhënat personale për të pandehurin dhe vendimin me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës për kundërvajtjen, e nëse është pezulluar procedura diapozitivi përmban vendimin mbi pezullimin e aktgjykimit.

4. Në arsyetimin e aktgjykimit shkurtimisht paraqiten vetëm arsytet esenciale mbi gjendjen e konstatuar faktike bashkë me theksimin e shkurtër të provave në bazë të të cilave faktet e caktuara konsiderohen të argumentuara, si dhe dispozitat në të cilat themelohet dispozitivi i aktgjykimit.

5. Udhëzimi mbi këshillën juridike përmban këshillën lidhur me faktin kush ka të drejtë ta paraqet ankesën kundër aktgjykimit për kundërvajtjen, brenda të cilit afat mund të paraqitet ankesa, kujt i dorëzohet ajo dhe kush vendos lidhur me ankesën.

Neni 131

Përmbajtja e dispozitivit të aktgjykimit për kundërvajtjen

1. Dispozitivi i aktgjykimit për kundërvajtjen me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës duhet medoemos të përmbajë:

- 1.1. kundërvajtjen për të cilën i pandehuri shpallet përgjegjës duke i shënuar faktet dhe rrethanat të cilat e formojnë tiparin e kundërvajtjes, si dhe ato prej të cilave varet aplikimi i dispozitës së caktuar ligjore ose i dispozitës tjetër;
- 1.2. dispozitat e ligjit ose të dispozitës tjetër me të cilën është përcaktuar kundërvajtja;
- 1.3. ndëshkimi i cili jepet;
- 1.4. masën mbrojtëse e cila jepet dhe në bazë të cilës dispozitë;
- 1.5. vendimin mbi shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes;
- 1.6. vendimi mbi kërkesën pasurore - juridike.

2. Nëse të pandehurit i është dhënë gjoba në dispozitivin e aktgjykimit për kundërvajtjen, do të theksohet brenda cilit afat i pandehuri duhet ta paguajë gjobën, respektivisht theksimin se gjoba në raste të mospagimit do të arkëtohet me dhunë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 132

Arsyetimi i aktgjykimit për kundërvajtjen

1. Në arsyetimin e aktgjykimit për kundërvajtjen, me të cilin pezullohet procedura e kundërvajtjes, theksohen shkurtimisht arsyet për shkak të të cilave është pezulluar procedura dhe dispozita në bazë të së cilës është bërë kjo gjë.
2. Në arsyetimin e aktgjykimit për kundërvajtjen, me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës, do të theksohen arsyet për secilin vendim nga dispozitivi i aktgjykimit, e veçmas do të arsyetohet për çfarë arsyesh është dhënë sanksioni.

Neni 133

Korrigjimi i aktgjykimit dhe vendimeve tjera

1. Gabimet e bëra në shkrimin e emrave dhe të numrave, si dhe gabimet e tjera të dukshme me rastin e shkrimit dhe të llogaritjes në aktgjykimin për kundërvajtjen korrigjohen sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e të pandehurit, paraqitësit të kërkesës ose të dëmtuarit.
2. Korrigjimi do të bëhet me aktgjykim të posaçëm dhe do të shënohet në origjinalin.
3. Nëse është fjala për gabimet lidhur me nenin 130, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të këtij ligji, kopjet e korrigjuara të aktgjykimit do t'u dërgohen personave, të cilët kanë të drejtë ankese kundër aktgjykimit. Në këtë rast, afati për ankesë rrjedh nga data e dërgimit të kopjes së korrigjuar të aktgjykimit.

Neni 134

Dërgimi i aktgjykimit për kundërvajtjen pjesëmarrësve në procedurë

1. Kur të pandehurit, aktgjykimi për kundërvajtjen, me të cilin është shpallur përgjegjës i komunikohet me gojë, do t'i dërgohet kopja me shkrim e aktgjykimit vetëm nëse e kërkon këtë gjë.
2. Nëse i pandehuri kërkon që t'i dërgohet kopja e aktgjykimit, gjyqtari është i obliguar që t'ia dërgojë, jo më vonë se brenda afatit prej tetë (8) ditësh, e nëse caktohet ekzekutimi i aktgjykimit për kundërvajtjen, para se ai të merr formën e prerë. Kopja e aktgjykimit të të pandehurit duhet medoemos t'i dërgohet, jo më vonë se brenda afati prej njëzet e katër (24) orësh.
3. Kërkesa nga paragrafi 1 dhe 2, i këtij neni shënohet në procesverbal.
4. Kopja e aktgjykimit për kundërvajtjen i dërgohet paraqitësit të kërkesës dhe të pandehurit, po që se nuk kanë hequr dorë nga e drejta për paraqitjen e ankesës, respektivisht nuk kanë deklaruar që të mos u dërgohet aktgjykimi.

KAPITULLI XXV MJETET E RREGULLTA JURIDIKE

Neni 135 E drejta në ankesë

1. Kundër aktgjykimit dhe aktvendimit për kundërvajtjen, të marrë në shkallën e parë, mund t'i paraqitet ankesa Gjykatës së Apelit (më tej: gjykata e shkallës së dytë) .
2. Kundër aktgjykimit për kundërvajtjen me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës, ankesën mund ta paraqes i pandehuri ose paraqitësi i kërkesës.
3. Në favor të të pandehurit ankesën mund ta paraqesin edhe bashkëshorti i tij, personi me gjininë e gjakut në vijën e drejtpërdrejtë, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor, adoptuesi dhe i adoptuari.
4. Nëse është dhënë masa mbrojtëse e marrjes së sendit pronari i të cilit nuk është i pandehur, pronari i sendit mund ta paraqes ankesën vetëm në pikëpamje të vendimit lidhur me atë masë.
5. Ankesa paraqitet brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga data e komunikimit verbal të aktgjykimit, respektivisht nga data e dërgimit të aktgjykimit për kundërvajtjen.
6. Ankesa e personit të autorizuar, respektivisht të organit të autorizuar e paraqitur në afat, e shtyn ekzekutimin e aktgjykimit dhe të aktvendimit për kundërvajtjen, përveç në rastet kur me këtë ligj është caktuar ndryshe.

Neni 136 Heqja dorë dhe abstenimi nga ankesa

1. I pandehuri dhe paraqitësi i kërkesës mund të heqin dorë nga e drejta për paraqitjen e ankesës pasi të komunikohet aktgjykimi për kundërvajtjen, kurse mund të abstenojë nga ankesa e paraqitur deri sa të merret aktgjykimi i shkallës së dytë.
2. Heqja dorë dhe abstenimi nga e drejta për paraqitjen e ankesës nuk mund të revokohet.
3. Heqja dorë e të miturit nga e drejta për paraqitjen e ankesës, nuk ka efekt juridik.
4. Nëse i pandehuri e paguan gjobën para se të merr formën e prerë aktgjykimi për kundërvajtjen, do të konsiderohet se në këtë mënyrë ka hequr dorë nga e drejta për paraqitjen e ankesës.
5. Nëse të pandehurit, aktgjykimi për kundërvajtjen i komunikohet me gojë, do t'i vihen në dijeni dispozitat nga paragrafi 4 i këtij neni.

Neni 137 Përmbajtja e ankesës

1. Ankesa duhet të përmbajë shënimin e aktgjykimit për kundërvajtjen kundër të cilit paraqitet edhe nënshkrimi i paraqitësit të ankesës.

2. Ankesa nuk është e domosdoshme të arsyetohet, por mjafton të shënohet për çka ankuesi është i pakënaqur me aktgjykimin.
3. Në ankesë mund të paraqiten fakte të reja dhe prova të reja. Duke u thirr në faktet e reja ankuesi është i obliguar që t'i shënojë provat me të cilat do të argumentoheshin këto fakte.
4. Nëse ankuesi në ankesë i paraqet edhe provat e reja është i obliguar t'i arsyetojë për çfarë arsye këto prova nuk i ka paraqitur më parë, si dhe t'i shënojë faktet të cilat me anë të provave të reja dëshiron t'i argumentojë.

Neni 138

Arsyet për të cilat mund të kundërshtohet aktgjykimi dhe aktvendimi

1. Aktgjykimi dhe aktvendimi mund të kundërshtohet për shkak të:
 - 1.1. shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës së kundërvajtjes;
 - 1.2. aplikimit të gabueshëm të ligjit material, me të cilin është paraparë kundërvajtja;
 - 1.3. vërtetimit të gabueshëm ose vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike;
 - 1.4. të vendimit për sanksione të kundërvajtjes, konfiskimit të dobisë pasurore, shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes dhe kërkesës pasure juridike.

Neni 139

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës së kundërvajtjes

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës së kundërvajtjes konsiderohet, nëse:
 - 1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari, i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi;
 - 1.2. në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet;
 - 1.3. shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa personat, prania e të cilëve në shqyrtim gjyqësor kërkohet me ligj ose kur të akuzuarit apo mbrojtësit, pavarësisht nga kërkesa e tij, i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet në shqyrtim gjyqësor dhe përcjellja e zbatimit të shqyrtimit gjyqësor në gjuhën e tij;
 - 1.4. publiku është përjashtuar nga esenca verbale në kundërshtim me ligjin;
 - 1.5. kërkesa është paraqitur nga paraqitësi jo i autorizuar;
 - 1.6. vendimin e ka marrë gjykata e cila nuk ka pasur kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes;
 - 1.7. gjykata me vendim nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës;

1.8. vendimi bazohet në provë të papranueshme;

1.9. dispozitivi i vendimit është i pakuptueshëm, kundërthënës me vetveten apo me arsyet e vendimit, ose vendimi nuk përmban arsyet apo në te nuk janë theksuar arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye plotësisht janë të pakuptueshme apo në masë të dukshme janë kundërthënëse.

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës së kundërvajtjes ekziston edhe kur gjykata gjatë kohës së përgatitjes së seancës verbale apo gjatë procedurës, ose me rastin e nxjerrjes së vendimit nuk ka aplikuar apo në mënyrë të padrejtë ka aplikuar ndonjë dispozitë të ligjit, ndërsa kjo ka qenë me ndikim për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Neni 140

Shkelja e ligjit material

1. Shkelje e ligjit material me të cilin është paraparë kundërvajtja, ekziston nëse gjykata nuk ka aplikuar apo gabimisht ka aplikuar dispozitat me të cilat përcaktohet, se:

1.1. a është kundërvajtje veprimi për të cilën ndiqet i pandehuri;

1.2. a ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje;

1.3. a ekzistojnë rrethana që përjashtojnë zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes, e sidomos nëse fillimi dhe zhvillimi i procedurës së kundërvajtjes është parashkruar ose më parë çështja është vendos në formë të prerë;

1.4. në pikëpamje të kundërvajtjes që është objekt i kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, a është aplikuar gabimisht ligji me të cilin është paraparë kundërvajtja;

1.5. me vendimin për dënim dhe masën tjetër a janë tejkaluar autorizimet që gjykata i ka sipas ligjit;

1.6. a janë shkelur dispozitat për llogaritjen e ndaljes ose të formës tjetër të privimit nga liria lidhur me kundërvajtjen.

Neni 141

Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike

1. Vendimi gjyqësor mund të kundërshtohet për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, nëse gjykata ndonjë fakt vendimtar gabimisht e ka vërtetuar ose nuk e ka vërtetuar.

2. Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston edhe kur për atë bëjnë me dije faktet ose provat e reja.

Neni 142

Procedura sipas ankesës

1. Ankesën, respektivisht prapësimin e paraqitur jo në kohën e duhur dhe të palejuar do ta hedhë poshtë me aktgjykim gjyqtari.
2. Nëse gjyqtari lëshon që ta hedhë poshtë ankesën e cila është paraqitur jo në kohën e duhur është e palejuar, ankesën do ta hedhë poshtë gjykata e shkallës së dyte.
3. Kur gjyqtari i cili e ka marrë aktgjykimin për kundërvajtjen lidhur me ankesën gjen se procedura nuk është e plotë, e kjo gjë ka mundur të ndikojë në rregullsinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit për kundërvajtjen, para se t'ia dërgojë gjykatës së shkallës së dytë do ta plotësojë procedurën brenda kufijve të thënieve në ankesë.
4. Nëse në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, gjyqtari konstaton se ankesa e cila është paraqitur në favor të të pandehurit, është e bazuar, aktgjykimi i mëparshëm për kundërvajtjen do të shfuqizohet dhe do të merret aktgjykimi i ri për kundërvajtjen, me kusht që aktgjykimi i ri për kundërvajtjen nuk mund të jetë më i disfavourshëm për të pandehurin.
5. Gjyqtari aktgjykimin e mëparshëm për kundërvajtjen gjithmonë do ta shfuqizojë dhe me aktgjykim do ta pezullojë procedurën e kundërvajtjes, nëse lidhur me ankesën e të pandehurit konstaton se ekziston ndonjëra prej arsyeve nga neni 100, paragrafi 1 i këtij ligji.
6. Ankesën bashkë me shkresën e lëndës, gjyqtari ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë, jo më vonë se brenda afatit prej tri (3) ditësh pasi të konstatojë se kanë kaluar afatet për paraqitjen e ankesës personave, respektivisht organeve të cilët në bazë të këtij ligji janë autorizuar të paraqesin ankesën, respektivisht nga data kur është plotësuar procedura.

Neni 143

Vendosja e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën

1. Duke vendosur lidhur me ankesën gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin për kundërvajtjen mund ta vërtetojë, ta ndryshojë ose ta shfuqizojë. Gjykata e shkallës së dytë nuk është e lidhur për arsyet e paraqitura në ankesë, e gjithmonë sipas detyrës zyrtare do të hetojë a ekziston shkelja e dispozitave të procedurës së kundërvajtjes, e cila do të ishte ose do të mund të jetë me ndikim për vendosjen ligjore.
2. Gjykata e shkallës së dytë, do ta refuzojë ankesën dhe do ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë kur konstaton se nuk ka arsye për shkak të të cilave shfuqizohet aktgjykimi ose që nuk ka arsye të tjera për shkak të të cilave mund të shfuqizohet apo të ndryshohet aktgjykimi.
3. Gjykata e shkallës së dytë, do ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, nëse konstaton se faktet vendimtare janë konstatuar në procedurën e shkallës së parë, e duke marrë parasysh gjendjen e konstatuar faktike se duhet të merret vendim tjetër ose nëse konstaton se ekzistojnë shkeljet e atilla të ligjit, të cilat mund të evitohen pa abrogimin e aktgjykimit të shkallës së parë ose me rastin e caktimit të dënimit, respektivisht të aplikimit të masës mbrojtëse, nuk janë marrë parasysh rrethanat që ndikojnë për caktimin e drejtë të dënimit, respektivisht për dhënien e ligjshëm të masës mbrojtëse ose kur rrethanat që janë marrë parasysh nuk janë vlerësuar drejtë.
4. Gjykata e shkallës së dytë, do ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë edhe kur konstaton

se gjyqtari gabimisht i ka vlerësuar dokumentet dhe provat të cilat nuk i ka administruar vetë, kurse vendimi është mbështetur në ato prova.

5. Gjykata e shkallës së dytë, do ta shfuqizojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën do ta kthejë në rishqyrtim nëse konstaton se ekziston shkelja e dispozitave të procedurës së kundërvajtjes që ka qenë me ndikim ose ka mundur të ndikojnë në vendosjen ligjore të çështjes së kundërvajtjes, apo nëse konstaton se për shkak të gjendjes së fakteve të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë, duhet të zhvillohet procedura e re. Për arsye të njëjta, aktgjykimi i shkallës së parë edhe mund të shfuqizohet pjesërisht, nëse disa pjesë të aktvendimit mund të veçohen pa pasoja të dëmshme për vendosjen e drejtë.

6. Nëse gjykata e shkallës së dytë, konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur kompetencë për të vendosur, do ta shfuqizojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën do t'ia dërgojë organit me kompetencë reale.

7. Nëse gjykata e shkallës së dytë me rastin e ankesës së cilitdo qoftë konstaton se arsyet për shkak të të cilave është marrë vendimi në favor të të pandehurit, i cili është ankuar, është në favor edhe për ndonjërin prej bashkë të pandehurve, i cili nuk e ka paraqitur ankesën ose nuk e ka paraqitur ankesën në atë drejtim, do të veprojë sipas detyrës zyrtare sikur të ekzistojë ankesa e tillë.

8. Nëse ankesa është paraqitur vetëm në favor të të pandehurit, aktgjykimi i shkallës së parë për kundërvajtjen nuk mund të ndryshohet në dëm të tij dhe që në procedurën e përsëritur të shkallës së parë mund të merret aktgjykimi, i cili është më i disfavorshëm për të pandehurin.

Neni 144

Arsyetimi i aktgjyimit të gjykatës së shkallës së dytë

1. Në arsyetimin e aktgjyimit gjykata e shkallës së dytë i çmon thëniet ankimore dhe vë në dukje shkeljen e ligjit, të cilën e ka marrë parasysh sipas detyrës zyrtare.

2. Kur shfuqizon aktgjykimin e shkallës së parë për kundërvajtjen për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës së kundërvajtjes, në arsyetimin e aktgjyimit do të theksohet cilat dispozita janë shkelur dhe ku konsiston shkelja.

3. Kur shfuqizohet aktgjykimi i shkallës së parë për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes së fakteve, do të theksohet ku konsistojnë të metat e procedurës, respektivisht pse provat dhe faktet e reja janë të rëndësishme dhe ndikojnë për marrjen e vendimit të drejtë.

Neni 145

Dërgimi i vendimit të gjykatës së shkallës së dytë

1. Gjykata e shkallës së dytë do t'ia kthejë të gjitha shkresat e lëndës gjykatës së shkallës së parë në numër të mjaftueshëm të kopjeve, të vërtetuara, të aktgjyimit të vet për kundërvajtjen për t'ia dërguar të pandehurit, paraqitësit të kërkesës dhe personave të tjerë të interesuar.

2. Gjykata e shkallës së parë është e obliguar që t'i administrojë të gjitha veprimet dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka vënë në dukje në aktgjykimin e vet gjykata e shkallës së dytë.

KAPITULLI XXVI MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE

Neni 146 Përsëritja e procedurës

1. Procedura e kundërvajtjes e përfunduar me aktvendim, e formës së prerë për kundërvajtjen, mund të përsëritet:

1.1. nëse argumentohet se vendimi është mbështetur në dokumentin e rrejshëm ose në dëshminë e rrejshme të dëshmitarit ose të ekspertit;

1.2. nëse argumentohet se vendimi është marrë për arsye se gjyqtari për kundërvajtje ose personi tjetër zyrtar i cili ka marrë pjesë në procedurë, kanë kryer veprën penale;

1.3. nëse konstatohet se i ndëshkuari për veprimin e njëjtë tashmë është ndëshkuar me procedurën e kundërvajtjes, ose për veprimin e njëjtë para se të merret vendimi për kundërvajtjen është shpallur fajtor në procedurën penale;

1.4. nëse paraqiten fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat do të ndikojnë që të merret vendim tjetër, sikur të ishin të njohura në procedurën e mëparshme.

2. Faktet nga paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, argumentohen me vendimin e formës së prerë të gjykatës se personat e përmendur janë shpallur fajtorë për veprat respektive penale. Nëse procedura kundër personave nuk mund të zhvillohet për arsye se kanë vdekur ose për arsye se ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, mund të konstatohen edhe me prova të tjera.

Neni 147

Paraqitja e kërkesës për përsëritje të procedurës dhe procedura sipas kërkesës

1. Kërkesën për përsëritjen e procedurës së kundërvajtjes mund ta paraqesin: i ndëshkuari dhe paraqitësi i kërkesës, kurse pas vdekjes së të ndëshkuarit kërkesën mund ta paraqesin edhe personat e tjerë të përmendur në nenin 134, paragrafin 3 të këtij ligji.

2. Kërkesa për përsëritjen e procedurës së kundërvajtjes mund të paraqitet brenda afatit prej një viti nga data kur ka marrë formën e prerë aktvendimi për kundërvajtjen.

3. Lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës së kundërvajtjes vendosë gjykata që ka marrë vendimin e shkalles së parë për kundërvajtjen.

4. Në kërkesë do të theksohet sipas cilës bazë ligjore kërkohet përsëritja dhe me cilat prova pohohen faktet në të cilat mbështetet kërkesa. Nëse kërkesa nuk i përmban këto të dhëna, ajo do të hedhet poshtë me aktvendim.

5. Kërkesa do të hedhet poshtë edhe nëse në bazë të kërkesës dhe të provave nga shkresat e lëndës nga procedura e mëparshme konstaton se kërkesën e ka paraqitur personi i paautorizuar ose është paraqitur jo në kohën e duhur, ose nuk ka kushte ligjore për përsëritjen procedurës, kurse kërkesa do të refuzohet nëse faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa qartas nuk

janë të përshtatshme që në bazë të tyre të lejohet përsëritja.

6. Kundër vendimit për hedhjen poshtë ose për refuzimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës, mund t'i ushtrohet ankesa gjykatës së shkallës së dytë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit.

7. Kërkesa për përsëritjen e procedurës së kundërvajtjes në dobi të të dënuarit mund të paraqitet edhe pasi që vendimi të jetë ekzekutuar.

Neni 148

Shtyrja e ekzekutimit të vendimit

1. Kërkesa për përsëritjen e procedurës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, por gjyqtari, nëse e çmon se kërkesa mund të aprovohet, mund të vendosë që të shtyhet ekzekutimi derisa të mos vendoset lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës.

2. Me aktvendim me të cilin lejohet përsëritja e procedurës shtyhet ekzekutimi i vendimit kundër të cilit është lejuar përsëritja.

3. Nëse lejohet përsëritja e procedurës në procedurën e sërishme nuk mund të merret vendimi i cili është më i disfavorshëm për të pandehurin.

Neni 149

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe vendosja sipas kërkesës

1. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të ngritet kundër aktgjykimit të formës së prerë për kundërvajtjen me të cilën është shkelur ligji ose dispozita tjetër për kundërvajtjen.

2. Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ngritë prokurori i shtetit brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data kur aktgjykimi për kundërvajtjen ka marrë formën e prerë.

3. Dispozitat e Kodit për Procedurën Penale lidhur me paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe vendosjen për të, përshtatmërisht do të zbatohen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në procedurën e kundërvajtjes.

KAPITULLI XXVII

PROCEDURA E POSAÇME

Neni 150

Procedura ndaj të miturve

1. Në procedurën e kundërvajtjes ndaj të miturit aplikohen dispozitat e këtij kapitulli, kurse dispozitat e tjera të procedurës së kundërvajtjes të parashikuara me këtë ligj aplikohen vetëm nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij kapitulli.

2. Procedura e kundërvajtjes ndaj të miturit është urgjente dhe gjithmonë jo publike.

3. Me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ndaj kryesit të mitur të kundërvajtjes në prezencën e tij, e posaçërisht me rastin e marrjes së tij në pyetje, personat që marrin pjesë në procedurë janë të obliguar të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin psikik, sensibilitetin dhe vetitë personale të të miturit.

4. Para shqiptimit të masës edukuese apo të dënimit të të miturit, sigurohet mendimi i organit kompetent të kujdestarisë, përveç nëse në ndërkohë i mituri është bërë madhor. Nëse organi kompetent i kujdestarisë nuk e dërgon mendimin në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, të miturit, gjykata mund t'i shqipton qortim apo dënimin me gjobë edhe pa mendimin e organit të kujdestarisë.

Neni 151

Thirrja e të miturit

1. I mituri thirret përmes prindit, respektivisht përfaqësuesit ligjor, përveç kur kjo gjë nuk është e mundur për shkak të nevojës së veprimit urgjent ose të arsyeve tjera.

2. Nëse i mituri nuk thirret nëpërmes prindit, respektivisht përfaqësuesit ligjor, gjykata e cila zhvillon procedurën e kundërvajtjes do t'i informoj ata për zhvillimin e procedurës.

Neni 152

Detyrimi për dëshmim

Askush nuk mund të lirohet nga detyra që të dëshmojë për rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit psikik të të miturit, për njohjen e personalitetit të tij dhe për rrethanat në të cilat jeton.

Neni 153

Veçimi dhe bashkimi i procedurës

1. Kur i mituri ka marrë pjesë në kryerjen e kundërvajtjes bashkë me personat madhorë, do të veçohet procedura ndaj tij dhe ajo do të zbatohet sipas dispozitave të këtij kapitulli.

2. Për shkaqe të arsyeshme procedura ndaj të miturit mund të zhvillohet bashkë me procedurën kundër personave madhorë dhe të zhvillimit sipas dispozitave të përgjithshme të këtij ligji.

3. Aktvendimin për veçim apo bashkim të procedurës, e nxjerr gjyqtari i cili zhvillon procedurën. Kundër këtij aktvendimi ankesa nuk është e lejuar.

Neni 154

Të drejtat e prindit dhe të kujdestarit

Në procedurën ndaj të miturit, organi i kujdestarisë dhe prindi, respektivisht kujdestari i të miturit kanë të drejtë që të njoftohen me rrjedhën e procedurës, që gjatë procedurës të bëjnë propozime dhe që t'i vënë në dukje faktet dhe provat që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë.

Neni 155**Oportuniteti i zhvillimit të procedurës**

1. Gjykata mund të vendosë që të mos fillojë procedura e kundërvajtjes kundër të miturit, nëse konsideron se nuk do të ishte oportune që të zhvillohet procedura duke marrë parasysh natyrën e kundërvajtjes dhe rrethanat në të cilat është kryer kundërvajtja, jetën e mëparshme të të miturit dhe cilësitë e tij personale.

2. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, me aktvendim do të hedhet poshtë kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes me arsyetimin për ç'arsye është hedhur poshtë kërkesa, kurse lidhur me kundërvajtjen e kryer do të informohen prindërit e të miturit, respektivisht kujdestari dhe organi i kujdestarisë për marrjen e masave në kuadër të autorizimeve të tyre.

Neni 156**E drejta e paraqitjes së ankesës**

1. Kundër aktvendimit mbi kundërvajtjen me të cilin i mituri është shpallur fajtor për kundërvajtjen, përveç personave nga neni 135, paragrafi 2 i këtij ligji, ankesën mund ta paraqesin edhe kujdestari, vëllai, motra dhe mbrojtësi i të miturit.

2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, mund ta paraqesin ankesën në favor të të miturit edhe kundër vullnetit të tij.

Neni 157**Veprimi ndaj fëmiut**

1. Kur gjykata konstaton se i mituri në kohën e kundërvajtjes së kryer nuk e ka mbushur moshën 14 vjeç, me aktvendim do ta pezullojë procedurën e kundërvajtjes.

2. Në rastin nga paragrafi 1 gjykata do t'i informojë prindërit, respektivisht kujdestarin e të miturit, si dhe organin e kujdestarisë për kundërvajtjen që është bërë, e sipas nevojë, mund ta informojë edhe shkollën, përkatësisht organizatën në të cilën është strehuar i mituri.

KAPITULLI XXVIII**KOMPENSIMI I DËMIT PËR SHKAK TË NDËSHKIMIT TË PAARSYESHËM****Neni 158****Kthimi i parave**

1. Personi të cilit në procedurën e kundërvajtjes në mënyrë të paarsyeshme, i është dhënë gjoba, masa mbrojtëse, e konfiskimit të përfitimit pasuror ose masa mbrojtëse e konfiskimit të sendit, ka të drejtë që t'i kthehet gjoba e paguar, t'i kthehet përfitimi i konfiskuar pasuror, t'i kthehet sendi ose vlerat në para të sendit të konfiskuar (më tej: kthimi i parave).

2. Konsiderohet se personi është ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme, nëse në rast të ndryshimit të aktgjykimit të formës së prerë për kundërvajtjen, ose të shfuqizimit të aktgjykimit të formës së prerë për kundërvajtjen, procedura kundër tij është pezulluar me formën e prerë për arsye se është konstatuar se vepra nuk paraqet kundërvajtje ose pse ekzistojnë bazat që e

përrjashtojnë përgjegjësinë e kryesit të kundërvajtjes, ose nuk ka prova se ai person e ka kryer kundërvajtjen.

3. Kthimin e parave nuk mund ta kërkojë personi i ndëshkuar, i cili me pohimin e vet të rrejshëm ka shkaktuar ndëshkimin.

4. Pas vdekjes së personit të ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme, kompensimin e dëmit, respektivisht kthimin e parave mund ta kërkojë bashkëshorti i tij dhe të afërmit e tij të cilët ai me ligj ka qenë i obliguar t'i mbajë.

Neni 159

Parashkrimi i të drejtës

1. E drejta e personit të ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme dhe e personit, të cilit ai sipas ligjit ka qenë i obliguar ta mbajë, të kërkojë kompensimin e dëmit, respektivisht kthimin e parave, parashkruhet për një vit nga data kur ka marrë formën e prerë aktgjykimi për kundërvajtje, me të cilin është pezulluar procedura e kundërvajtjes.

2. Parashkrimi nga paragrafi 1 i këtij neni, ndërpritet me paraqitjen e kërkesës së Ministrisë kompetente për çështjet të financave.

3. Nëse kërkesën për kompensimin e dëmit, respektivisht kthimin e parave e ka paraqitur personi i ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme, pas vdekjes së tij, personat nga neni 158, paragrafi 4 i këtij ligji, mund ta vazhdojnë procedurën për realizimin e kërkesës brenda kufijve të kërkesës së paraqitur më parë.

4. Nëse personi i ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme ka hequr dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit, respektivisht për kthimin e parave, pas vdekjes së tij, kërkesa nuk mund të paraqitet.

Neni 160

Procedura e realizimit të të drejtave

1. Personi i autorizuar, i drejtohet me kërkesë për kompensimin e dëmit Ministrisë kompetente për punët e financave, organi i së cilës ka dhënë sanksionin për të arritur marrëveshjen mbi ekzekutimin e dëmit dhe mbi lartësinë e kompensimit.

2. Nëse nuk arrihet marrëveshja brenda afatit prej dy muajsh nga data e marrjes në dorëzim të kërkesës, personi i autorizuar mund ta paraqes padinë për kompensimin e dëmit kundër Republikës së Kosovës, dhe ta fillojë procedurën pranë gjykatës kompetente brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kalimit të afatit për arritjen e marrëveshjes.

3. Kërkesa për kthimin e parave i paraqitet Ministrisë kompetente për financa në favor të së cilës janë paguar të hollat. Nëse organi kompetent e refuzon kërkesën ose në afat prej dy (2) muajsh nuk nxjerr aktvendim sipas kërkesës, personi i autorizuar kërkesën e vet mund ta realizojë me anë të padisë për kompensimin e dëmit pranë gjykatës kompetente brenda afatit nga paragrafi 2 i këtij neni.

4. Me kërkesën e personit, prestigji i të cilit është cenuar rëndë për shkak të ndëshkimit të paarsyeshëm, e posaçërisht, nëse rasti është i paraqitur në mjetet e informimit publik, në ato

mjete do të publikohet kumtesa lidhur me vendimet nga i cili rezulton ndëshkimi i paarsyeshëm i atij personi. Nëse në ndërkohë vdes personi i ndëshkuar, e drejta për paraqitjen e kësaj kërkesë i takon bashkëshortit të tij, fëmijëve dhe prindërve.

KAPITULLI XXIX EKZEKUTIMI I SANKSIONEVE PËR KUNDËRVAJTJEN

Neni 161 Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimi për kundërvajtjen ekzekutohet kur e merr formën e prerë, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.
2. Vendimi për kundërvajtjen ka marrë formën e prerë kur nuk mund të atakohet me ankesë ose kur nuk është e lejuar ankesa.
3. Vendimi për kundërvajtjen me të cilin është dhënë gjoba ose është vendosur për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe për kompensimin e dëmit ose është dhënë masa mbrojtëse e marrjes së përfitimit pasuror, ekzekutohet kur kalon afati i caktuar në aktvendim për pagimin e gjobës së shpenzimeve të procedurës, kompensimit të dëmit, respektivisht të përfitimit pasuror.

Neni 162 Ekzekutimi i vendimit para marrjes së formës së prerë

1. Vendimi për kundërvajtjen mund të ekzekutohet edhe para se të merr formën e prerë në këto raste, nëse i pandehuri nuk mund ta argumentojë identitetin e vet ose nuk e ka vendbanimin, ose nëse shkon për të qëndruar në botën e jashtme, kurse gjyqtari konstaton se ekziston dyshimi i bazuar se, i pandehuri do ta pengojë ekzekutimin e dëmit të dhënë.
2. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata në aktgjykim do të konstatojë që i pandehuri edhe para marrjes së formës së prerë të filloj me zbatimin e sanksionit të shqiptuar.
3. Nëse i pandehuri e paraqet ankesën kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, gjyqtari është i obliguar që ankesën bashkë me shkresat t'ia dërgojë gjykatës së shkallës së dytë brenda afatit prej njëzetekatër (24) orësh, duke llogaritur prej orës kur e ka marrë në dorëzim ankesën. Gjykata e shkallës së dytë është e obliguar që të vendosë lidhur me ankesën dhe t'ia dërgojë vendimin e vet gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orësh, duke e llogaritur prej orës kur i ka marrë në dorëzim shkresat e lëndës.
4. Vendimi për kundërvajtjen, i marrë në procedurën ndaj të miturit, nuk mund të ekzekutohet para se të merr formën e prerë.

Neni 163 Ekzekutimi i dënimit me gjobë dhe shpenzimeve tjera

1. Gjobën e dhënë për kundërvajtjen dhe shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes i ekzekuton gjykata që e ka dhënë ndëshkimin.

2. Gjoha dhe shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes paguhen me anë të postës ose të bankës me mandapostën e posaçme të lëshuar nga gjykata, brenda afatit të caktuar me aktgjykimin për kundërvajtjen.
3. Lidhur me pagesën e bërë të gjobës dhe të shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes, personi i ndëshkuar është i obliguar që pa shtyrje ta informojë gjykatën që e ka marrë aktgjykimin mbi ndëshkimin.
4. Arkëtimi me dhunë i gjobës për kundërvajtjen e kryer dhe i shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes bëhet sipas dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit.
5. Organi kompetent për arkëtimin me dhunë nga paragrafi 1 i këtij neni, është i obliguar që ta informojë pa shtyrje gjykatën kompetente të kundërvajtjes lidhur me arkëtimin e bërë, si dhe për pamundësinë eventuale të arkëtimin të dhunshëm.

Neni 164

Ekzekutimi i masës mbrojtëse të konfiskimit të sendit

1. Masën mbrojtëse të konfiskimit të sendit që është përdorur ose ka qenë i destinuar për kryerjen e kundërvajtjes, ose ka lindur me kundërvajtjen e kryer, e ekzekuton gjykata që në shkallën e parë e ka dhënë këtë masë.
2. Sipas natyrës së sendeve të marra, gjykata nga paragrafi 1 i këtij neni, me aktvendim do të vendosë, a do të shiten sendet e këtilla sipas dispozitave që vlejné për ekzekutimin e tatimit sipas dispozitave mbi tatimet apo do t'i dorëzohen ndonjë institucioni profesional ose publik kriminalistik, organizate apo do të asgjësohen.
3. Nëse i ndëshkuari krye në vete, e ka jetësuar ose asgjësuar sendin e kundërvajtjes ose në ndonjë mënyrë tjetër ka bërë të pamundur ekzekutimin, me vendim të posaçëm të gjykatës së kundërvajtjes do të obligohet që t'i paguajë të hollat që i përgjigjen vlerës së atij sendi.
4. Të hollat e fituara nga shitja e sendit që është në pronësinë e të ndëshkuarit, derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Nëse sendi nuk është në pronën e të ndëshkuarit, të hollat nga sendi i shitur i dorëzohen pronarit.
5. Nëse pronari është i panjohur ose nuk paraqitet brenda afatit prej një viti, të hollat e fituara janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Kosovës.
6. Masën mbrojtëse të konfiskimit të përfitimit pasuror e zbaton gjykata që e ka marrë vendimin për kundërvajtjen.
7. Ekzekutimin me dhunë të kësaj mase e bën organi kompetent për punët e të hyrave sipas dispozitave që vlejné për arkëtimin me dhunë të tatimit.
8. Prej pasurisë së palejueshme me dhunë mund të arkëtohet përfitimi pasuror që është mbi pesëdhjetë (50) euro.
9. Arkëtimin me dhunë të konfiskimit të përfitimit pasuror nga pasuria e paluajtshme, e bën gjykata sipas dispozitave të procedurës së përmbarimit.

10. Përfitimi i konfiskuar pasuror është e hyrë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, po që se me ligj të posaçëm nuk është caktuar ndryshe.

11. Shpenzimet e ekzekutimit i paguan personi i ndëshkuar.

12. Ekzekutimi i masës mbrojtëse të konfiskimit, të përfitimit pasuror të dhënë personit juridik, që ka pushuar të ekzistojë pasi e ka marrë formën e prerë vendimi për kundërvajtjen do të zbatohet kundër personit juridik, i cili e ka marrë përsipër pasurinë e tij deri në lartësinë e pasurisë së marrë përsipër.

Neni 165

Ekzekutimi i masës mbrojtëse të dëbimit të shtetasit të huaj prej vendit

1. Masën mbrojtëse të dëbimit të shtetasit të huaj prej vendit, e ekzekuton organi kompetent i punëve të brendshme sipas dispozitave mbi lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasit të huaj në Republikën e Kosovës.

2. Gjykata e cila ka vendos në shkallë të parë është e obliguar që vendimin e formës së prerë për kundërvajtjen me të cilin është dhënë masa nga paragrafi 1 i këtij neni, pa shtytje t'ia dërgojë Policisë së Kosovës për ekzekutim.

Neni 166

Kompensimi i dëmit

Kompensimi i dëmit dhe kthimi i sendeve në bazë të aktvendimit të formës së prerë për kundërvajtjen bëhet në bazë të kërkesës së të dëmtuarit, respektivisht të pronarit të sendit. Arkëtimi me dhunë bëhet sipas dispozitave që vlejnjë për procedurën e përmbarrimit.

KAPITULLI XXX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 167

Harmonizimi i dispozitave që nuk janë në pajtim me këtë ligj

Dispozitat për kundërvajtjen që nuk janë në pajtim me këtë ligj, do të harmonizohen brenda afatit prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 168

Procedurat e filluara dhe zbatimi i vendimeve

1. Procedurat të cilat janë rrjedhë, do të përfundojnë sipas dispozitave të ligjit ekzistues, por më së gjati në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

2. Dënimet e shqiptuara të formës së prerë do të ekzekutohen sipas ligjit/legjisllacionit ekzistues.

3. Dënimet e shqiptuara në shkallë të parë sipas legjisllacionit ekzistues deri në nxjerrjen e vendimit të formës së prerë do të zëvendësohen me sanksionin adekuat, burgu duhet të

zëvendësohet me gjobë, por nëse vije deri tek përsëritja e procedurës, procedura e re do të zhvillohet sipas këtij ligji.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, procedurat e kundërvajtjes të cilat nuk kanë përfunduar me dispozitat e legjislacionit ekzistues për kundërvajtjet, do të përfundojnë sipas këtij ligji, nëse janë më të favorshme për të pandehurin.

Neni 169
Nxjerrja e akteve nënligjore

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të nxirren në afat prej gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 170
Pushimi i vlefshmërisë së legjislacionit ekzistues në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë legjislacioni në fuqi për kundërvajtjen.

Neni 171
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në janar të vitit 2017.

Ligji Nr. 05/L-087
5 gusht 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-035-2016, datë 23.08.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.